

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7574 E shtunë 30 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje në "Deutsche Welle"
Çfarë mund të arrijë Donald Trumpi në një takim të nivelit të lartë me Vladimir Putinin? Pak. Rusia nuk do të tërhiqet në asnjë mënyrë nga Krimea. Ajo do të vazhdojë...
Vijon në faqen 21

Nga Miodrag SORIÇ
Putini fiton, Trumpi jo



Opinion Ditës
Dikur një politikan relevant shqiptar pat thënë se Shqipëria mund të pranohet në BE në 100-vjetorin e mbarimit të Luftës së Parë Botërore, pra do i takonte diku...
Vijon në faqet 20-21

Nga PËRPARIM KABO
Anëtarësimi në BE, si lexohet jashtë propagandës së partive



23 të shoqëruar në komisaratin nr. 4
'Beteja' me armë në 'Kinostudio', i plagosuri: Nuk i pashë atentatorët

Dyshimet e policisë, nga plagosja e vjetër, te droga. 36-vjeçari: Nuk e di motivin e sulmit
Nga INA ALLKANJARI
Dy ditë pas përplasjes me armë zjarri mes dy grupeve rivale në zonën e "Kinostudios" në kryeqytet, dalin në dritë të tjera detaje. Ndërsa ngjarja mbetet ende pa autor, mësohet se pista kryesore mbi të cilën po heton...

Në faqen 6

ANOMALIA/ STUDENTEVE TE VITEVE 2002-2006 NUK U NJIHET DIPLOMA E MASTERIT

INFERMIERET: NA ULEN PAGAT, E ÇOJME NE GJYQ

4 mijë profesionistë të shëndetësisë rrezikojnë përgjysmim rroge. Shoqata: Faji i fakultetit. Ministria e Arsimit: Do ta zgjidhim



(Në foto) Foto ilustruese

NDERTIMET PA LEJE
Kompensimi, 157 pronarët që ndajnë fondin 167 milionë lekë
Në faqen 5

AKTORI I NJOHUR
Robert Ndrenika: Kam qenë dhe jam për një teatër të ri. Krasta: Jo shembjes
Në faqen 12

ME SYTE NGA GJYKATAT
Koncesionet, abuzimet mund të ndalen me një mënyrë të re
Në faqet 8-9

FLET I ATI
U vra barbarisht në Itali, sillet në Shqipëri trupi i Anxhela Meçanit
Në faqen 7

INTEGRIMI NE BE
Negociatat, Edi Rama nderon 4 ambasadorë. Basha: Dështim
Në faqet 2-3

BLUE TOOTH Detajet e ceremonisë së modeles nga Kosova dhe hokeistit. Kush u ftua nga Tirana?
"Barbie dhe Ken", dasma luksoze e Afërdita Dreshajt
Klodiana Shala: Pengu më i madh i jetës. Hana Noka, një modele-regjisore

Nga PAMELA ALIAJ
Prej kohësh e presim me padurim dasmën e këngëtares bukurshes nga Kosova, Afërdita Dreshajt me hokeistin çek, Jakub Kindl Scoresa. Që prej momentit që i dashuri i saj i propozoi në tarracën e një prej hoteleve më të



njohur në Pragë të Çekisë, këngëtarja nuk ka reshtur të shfaqë çdo moment romantik të kaluar në krah të të dashurit të saj të zemrës. Ajo ka marrë propozimin për martesë, që do ta kishin zili shumë vajza. Tamam si në filma, këngëtarja dhe...
Suplement

NEGOCIATAT AKUZAT

Kreu i PD-së: Meta t'i vërë veto projektligjit. Do ndalim grabitjen e Teatrit Kombëtar

Shtyrja e negociatave, Basha: Rama sundon mbi perandorinë e krimit

"3.4 milionë eurot janë të bandës së Elbasanit"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha ka bindjen e plotë se pa rrëzuar qeverinë "Rama", negociatat me BE-në nuk do të hapen as vitin e ardhshëm. Sipas tij, e vetmja pengesë për ndezjen e dritës jeshile për Shqipërinë është largimi i Edi Ramës nga qeveria. "Nuk do hapen nëse do kemi Fatmir Xhafajn ministër të Brendshëm dhe Edi Ramën që sundon në këtë qeveri krimi, pasi Rama mbron Saimirin, Tahirin dhe sundon mbi perandorinë e krimit dhe e kthen vendin në hambar droge. Rama sundon mbi perandorinë e krimit, ju jep trafikantëve të drogës lirinë dhe përdor paratë e drogës për të ndërtuar kulla. Sa kohë ndodh kjo, nuk do të ketë hapje negociatash me Shqipërinë. Ky është mësimi i 2016, i 2018 dhe nëse shqiptarët nuk e mësojnë do të jetë dhe mësimi i 2019. Politikantët që janë faktuar të lidhur me krimin të shkojnë para drejtësisë. Asnjë politikant të mos i garantohet mbrojtje, siç po bëhet me Tahirin, Xhafajn, apo me Ballën, garantuesin e parave të drogës. Integrimin po e mbron një qeveri e lidhur kokë e këmbë me krimin. Rama garanton trafikun e drogës, por ka vënë dhe qeverinë në shërbim të pastrimit të parave", shprehet z.Basha. Forma dhe mënyra për të larguar qeverinë Basha bëri të ditur se do të diskutohet ditët në vijim, por bojkoti i parlamentit, një paralajmërim i dhënë me shqetësim këtë javë edhe nga Këshilli Europian, nuk përjashtohet si opsion. "Do kundërshtojmë në komisione dhe në Kuvend projektin e Teatrit të ri, sepse Rama do të marrë 50% të milionave, të pastrojë paratë e drogës. Ne do ta kundërshtojmë këtë. Do t'i kërkojmë presidentit të mos bëhet pjesë e kësaj grabitjeje dhe t'i vërë veton çdo ligji që të kalojë në Kuvend. Do e bëjmë presion ndërkombëtareve që ka një përgjegjësi që vendi është



BOJKOTI

"Të gjitha opsionet janë në tavolinë, diskutimet kanë nisur dhe do intensifikohen ditët në vijim. Ne do ta kundërshtojmë në çdo instancë. Do i kërkojmë presidentit të mos bëhet pjesë e kësaj grabitjeje dhe t'i vërë veto. Do u bëjmë presion ndërkombëtareve që ka një përgjegjësi që vendi është pa Kushtetuese. Të bëjmë gjithçka për ta ndaluar këtë grabitje", u shpreh z.Basha.

"Garantuesi i parave në 'Toyota Yaris'"

Berisha: Terror i egër në SHISH për nxjerrjen e emrit të Ballës

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se prej tri ditësh, me urdhër të kreut të qeverisë, Edi Rama, po ushtrohet terror ndaj punonjësve të SHISH. Sipas tij, kjo gjë po ndodh, pasi ata dyshojnë se punonjësit e SHISH nxorën emrin e deputetit socialist, Taulant Balla si garantues i parave në makinë "Toyota Yaris" të gjetura disa ditë më parë në Portin e Durrësit. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Berisha thotë se "Procedurat e terrorit psikologjik që përdorin ish-xhelatët e Sigurimit të Shtetit konsistojnë ndër të tjera në seanca të zgjatura edhe deri në 7 orë pyetje dhe kërcënimesh



të paktën deri dje pasdite në katër raste". Ai u bëri thirrje deputetëve të Komisionit parlamentar të Sigurisë të ndërmarrin me urgjencë hetimin e këtij rasti dhe të informojnë sa më shpejt publikun. "Me urdhër të Edvin Kristaq Ramës, ish-

xhelatët e policisë sekrete të Enver Hoxhës, aktualisht drejtorë kryesorë në Shërbimin Informativ, ushtrojnë një terror të paparë ndaj punonjësve të këtij Shërbimi, tek të cilët ata dyshojnë se kanë informuar Bashën për emrin e Taulant Yaris si garantues i tri pakove me nga 1.5 milionë euro para droge, bazuar në informacionet e dhëna nga shërbime partnere. Procedurat e terrorit psikologjik që përdorin ish-xhelatët e Sigurimit të Shtetit konsistojnë ndër të tjera në seanca të zgjatura edhe deri në 7 orë pyetje dhe kërcënimesh të paktën deri dje pasdite në katër raste", shprehet z.Berisha.

Gjykatë Kushtetuese. Do të protestojmë për të ndaluar këtë grabitje", tha kreu i PD-së. Intensifikimi i aksionit opozitar thotë se do të nisë me projektligjin që parashikon prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar, pas së cilës Basha shprehet se fshihen interesa korruptive të kryeministrit. Basha paralaj-

mëroi protesta për të bllokuar projektin për ndërtimin e Teatrit të ri Kombëtar, ndërsa i bëri thirrje presidentit që të vendosë veton për të bllokuar projektligjin e qeverisë. "Të gjitha opsionet janë në tavolinë, diskutimet kanë nisur dhe do intensifikohen ditët në vijim. Edi Rama do të marrë 50% të

milionave të drogës. Ne do ta kundërshtojmë në çdo instancë. Do i kërkojmë presidentit të mos bëhet pjesë e kësaj grabitjeje dhe t'i vërë veto. Do u bëjmë presion ndërkombëtareve që ka një përgjegjësi që vendi është pa kushtetuese. Të bëjmë gjithçka për ta ndaluar këtë grabitje. Do të protestojmë për të



Akuzat për makinat me euro, Balla: Padia e tretë për Bashën

Sekretari i përgjithshëm i PS, Taulant Balla, reagoi pas akuzave të Lulzim Bashës në lidhje me 3.4 mln eurot e bllokuara në Durrës. Balla shprehet se është duke vlerësuar mundësinë për të depozituar një padie të tretë ndaj Bashës, pasi sipas tij, ka shpifur kundër grupit parlamentar të PS. Përsa i përket 3.4 mln eurove, Balla deklaroi se lidhja e PD me të kërkuarit është antike, ndërsa e Bashës së paku fotografike. "Pas shpifjeve dhe ofendimeve të reja të Lulzim Bashës, tanimë drejtuar gjithë grupit parlamentar, ndërkohë që jemi të bindur se afera e eurove të sekuestruara do të zbardhet plotësisht pasi të kapen autorët në kërkim (me të cilët lidhja e PD është antike ndërsa e Lulzim Bashës me ta është së paku fotografike), po vlerësojmë çuarjen në Gjykatën e Krimeve të Rënda të një padie të tretë, në tri ditë, për gojë e tij të përdalë totalisht pas vendimit të Këshillit Europian për datën e negociatave", tha z.Balla.

PD: Droga dhe pastrimi i parave të pista e la Shqipërinë pa negociata

PD akuzoi dje se droga dhe pastrimi i parave të pista nga organizatat kriminale me mbështetje qeveritare janë dy arsye kryesore që Shqipërisë nuk iu hapën negociatat dhe as kanë për t'u hapur në qershor të 2019. Deputeti Flamur Noka tha se dëshmia e zyrtarëve të policisë italiane dhënë gazetës "Liberatio" se në Shqipëri vazhdon të mbillet kanabis në sasi të mëdha është provë tjetër se Edi Rama mashtron kur thotë se e ka hequr Shqipërinë nga harta ku prodhohet kanabis. "Në Bari janë bllokuar 10 tonë drogë në katër muajt e fundit, që nuk është prodhim nga stoku i vjetër, por prodhim i muajve të fundit, koha kur Rama shpalli fitoren kundër kultivimit të drogës. Mediat europiane shkruajnë se paratë e drogës janë para të politikës në pushtet", - tha z.Noka. Sipas tij, "është koha të largojmë Edi Ramën dhe bandën e tij që t'i hapim rrugën Shqipërisë drejt Europës".

ndaluar këtë grabitje", u shpreh z.Basha. Socialisti Taulant Balla i publikoi foton ku shfaqej në zyrën e tij me vëllain e njërit prej personave të shpallur në kërkim për 3.4 milionë eurot e sekuestruara, por Basha i pvetur për këtë çështje mohoi çdo lidhje me kushërinjtë Vladi. "Personi në fjalë nuk më thotë as-

gjë, po lidhja me foton më tregon se Taulant Balla është garantuesi i kalimit të parave të bandës së Elbasanit. E ka marrë foton nga banda e Elbasanit. Unë si politikan takoj me mijëra njerëz. Një gjë është e saktë, nëse është ashtu, ta marrin ta arrestojnë", theksoi kreu i PD-së.



Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama sqaroi dje se Bashkimi Evropian nuk ka vënë asnjë kusht shtesë, por të gjitha çka duhet të bëjë qeveria në 12 muaj janë reformat e nisura që nga ajo e drejtësisë, lufta kundër krimi dhe korrupsionit etj. Gjatë takimit dje me strukturat e integritetit evropian në Ministrinë e Jashtme, në prani edhe të ambasadorëve të huaj në Tiranë, Rama falënderoi ambasadorin e BE-së, Romana Vlahutin, Italinë e Greqinë që sipas tij bënë atë që do të kishte bërë vetë qeveria shqiptare, nëse do të ishte e pranishme në tryezën e BE-së. "Në mënyrë shumë të veçantë dua edhe njëherë të nënvizoj atë që në 72 orët e dallgëve të larta të procesit, fillimisht në Luksemburg dhe pastaj në Bruksel bënë fqinjët tanë, fqinjët tanë grekë dhe fqinjët tanë italianë. Në kuptimin më të vërtetë të fjalës bënë asgjë më pak sesa do të kishim bërë ne vetë, nëse do të ishim të pranishëm. Pra, ne mungonim, por falë angazhimit të jashtëzakonshëm të këtyre dy miqve, ne nuk munguam aty", u shpreh Rama. "Më vjen jashtëzakonisht mirë që sot ne kemi kapërcyer një moment tejet delikat, ku edhe pse, sikundër është nënvizuar pa përjashtim nga të gjithë dhe është njohur nga të gjithë, jo vetëm nga Komisioni, jo vetëm nga partnerët, por edhe nga ata më skeptikët, që Shqipëria ka bërë përpara çeljes së negociatave më shumë se çdo vend tjetër në të njëjtën fazë, ishte realisht një rrezik real që të mbeteshim në këtë moment pa tekst", theksoi kryeministri. Ai sqaroi edhe atë çfarë është bërë pika e debatit në Shqipëri pas vendimit të Këshillit të BE-së. "Vërtetë ka një ndryshim midis çeljes imediate të negociatave në 12 muaj, këtë nuk mund ta fshihim, por ndryshimi është shumë më formal seç duket në pamje të parë, por arsyen e thjeshtë se, edhe sikur hipotetikisht çelja e negociatave të ishte imediate, ne do të na duhej një periudhë pune përgatitore, i ashtuquajtur 'screening' i procesit, që do të merrte një kohë të caktuar, një kohë që normalisht shtrihet nga 6 deri në 12 muaj", sqaroi Rama. Ai konfirmoi se komisioni do të nisë menjëherë procesin përgatitor. "Për ne, reforma në drejtësi, unikale në të gjithë procesin e integritetit evropian të të gjithë vendeve anëtare, e gjithëpranuar si një model që duhet shtrirë më tutje në të gjithë rajonin tonë, një reformë radikale

Kryeministri nderon 4 ambasadorët, falënderon Greqinë dhe Italinë

Negociatat më 2019-ën, Rama: Nuk kemi humbur 12 muaj, kemi 12 muaj punë

"Ndryshimi midis çeljes imediate të negociatave dhe çeljes pas 12 muajsh, formal"



Kryeministri Edi Rama

PETRIT VASIL

"Kryeministri me gjuhën e varfëruar deri në shkretim dhe me logjikën grupë si gojë pa dhembë, gajasi dyndjanë me këtë mbylljen e negociatave që ia tregojnë si hapje dhe ky e thotë dhe e thotë pa pushim. Ndaj për ta ndihmuar këtë kryeministër që vetëm tall e përçmon veten dhe që s'ia var më trastën njeri, vlen këshilla monumentale e Oskar Wilde që thotë: 'Ndonjëherë është më mirë të qëndrosh i qetë dhe të dukesh budalla se sa të hapësh gojën dhe të heqësh çdo dyshim që je i tillë'".

Votimi elektronik, Çuçi: Projekt pilotimi për zgjedhjet vendore të 2019-ës

Votimi elektronik do të pilotohet në disa bashki në zgjedhjet vendore të 2019-ës. Bashkëkryetari socialist i Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, Bledi Çuçi u shpreh dje për gazetarët se kanë rënë dakord edhe me opozitën për aplikimin në disa njësi vendore në zgjedhjet e ardhshme. "Nëse do përdorim teknologjinë në procesin zgjedhor, hapi i parë do të jetë pilotimi, për këtë kemi rënë dakord. Nuk jemi në fazën e llogaritjes së kostos, nëse do bëjmë pilotimin, do jetë për 2019-ën. Ky model do të aplikohet vetëm për zgjedhjet e përgjithshme, kurse vendoret lidhen strikt me njerëzit që banojnë në një bashki të caktuar", tha ai. Bashkëkryetari i Komisionit të Reformës Zgjedhore theksoi se ndryshimet në kod do të përfundojnë në vjeshtë. "Fryma bashkëpunuese ekziston dhe nuk ka asnjë arsye të mos përfundojmë brenda vjeshtës një paketë të plotë amendimesh rregullatore për të adresuar në mënyrë të plotë rekomandimet e ODHR", u shpreh Çuçi. Gjithashtu Bledi Çuçi deklaroi që Partia Socialiste është e gatshme për depolitizimin e komisioneve të qendrave të votimit si dhe të zonave të administrimit zgjedhor.

Negociatat, Bushati: Kemi nxjerrë disa mësimë, nuk themi që jemi 100% gati

Ministri për Evropën e Punët e Jashtme, Ditimir Bushati e vlerësoi dje si mesazhin e parë më pozitiv që vjen nga vendimarrja e vendeve anëtare të BE-së, caktimin e datës për hapjen e negociatave në qershor 2019. Duke iu drejtuar edhe stafit të ekspertëve që do të punojnë në këta muaj të përgatitjeve, Bushati tha: "Katër janë elementet që dëshiroja të nënvizoj që në fakt do të jetë edhe bërthama e sekretariatit të ekipit të ardhshëm negociator". "Kemi nxjerrë disa mësimë. Nuk mund të themi që kemi qenë 100% dhe jemi 100% gati. Në këtë proces, së bashku me Komisionin Evropian kemi kuptuar që kemi kufizime, kemi mangësi në sektorë dhe politika të caktuara. I jemi shumë mirënjohës delegacionit të Bashkim-



Ditimir Bushati

it Evropian, ekspertizës SMEL-t, që është këtu me ne dhe me të cilët kemi hartuar një koncept strategjik se si do t'i përgasemi tryezës së bisedimeve për anëtarësimin", u shpreh Bushati. Sipas Bushatit, detyra e dytë është fuqizimi i mekanizmit të bashkërendimit, jo thjesht në nivel qeveritar që drejtohet nga kryeministri, por struktura të tjera, siç është struktura parlamentare, duke qenë se është Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian, Komisioni i Politikës së Jashtme, Komisioni i Integritetit Evropian, institucione të pavarura, etj. "Në këtë proces nuk më ka bërë habi, por jam shumë i lumtur që fqinjët tanë kanë qenë avokatët më të zjarrtë të Shqipërisë", tha Bushati.

me kosto jo të vogla të natyrave të ndryshme, për të cilën ne rrezikuam vetë koalicionin qeverisës; nga ana tjetër, një shembull, që mbase nuk është krejt paralel, sepse është mbase edhe më radikal për rëndësinë që ka Europa në këtë territor, fakti që fqinjët tanë pranuan të ndërrojnë emrin", u shpreh kreu i qeverisë. Duke treguar bisedën që kishte bërë me homologun e Mlait të Zi për

kushtet e BE-së, Rama tha se, "është gjëja më normale për këtë proces dhe të gjithë njerëzit duhet ta kuptojnë se këtu nuk është çështje kushtesh speciale. Këtu është çështje përputhshmërie në çdo aspekt të organizimit të shëtit tonë me organizimin e një shteti në parametrat e një vendi anëtar të Bashkimit Evropian, pra është sinkronizimi i të gjithë elementëve për t'i bërë dy orga-

nizmat një, për t'i bërë dy (nëse mund të përdor këtë krahasim) kompjuterat që të flasin me njëri-tjetrin, dy sistemet që të flasin me njëri-tjetrin". "Nuk kemi humbur 12 muaj. Kemi 12 muaj punë, që është e njëjta punë që do të kryehet edhe nëse do të thuhet në tekst, negociatat hapen sot. Por kemi një tekst që na mundëson të bëjmë punë tonë dhe të gjithë ata që kishin hall se do t'ju ngriheshin

"Koncerti im i fundit", Donald Lu: Nder i madh që kam qenë në udhëtim me ju

Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu organizoi dje priten e fundit me rastin e 242-vjetorit të Pavarësisë së Amerikës. Ai ka mbërritur në Shqipëri, pas fjalës së mbajtur dje në Senat. Lu ka përshëndetur të pranishmit, mes të cilëve ishin Presidenti Ilir Meta, kreu i PD-së Lulzim Basha, ish-presidenti Bamir Topi, kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj, kreu i grupit parlamentar të PS Taulant Balla, deputetja e LSI Klajda Gjoshaj etj. "Meqë qishtë koncerti im i fundit i Ditës së Pavarësisë me ju, më lejoni të them që ka qenë një nder i madh që kam bërë këtë udhëtim me ju", tha Lu në fjalën e tij të shkurtër para të pranishmëve, që më pas kanë vijuar festën.

në këmbë njerëzit që 'pse i hapët menjëherë negociatat me Shqipërinë dhe me Maqedoninë', të bëjnë punën e tyre, të thonë 'jo'. Ja, kjo është e gjitha", theksoi Rama. Kryeministri dekoroi dje me medaljen e mirënjohjes ambasadorin tonë në Holandë, Adia Sakiqi, ambasadorin në Bruksel, Suela Janina si dhe ambasadorët Artur Kukoi në Gjermani e Dritan Tola në Francë.

NJOFTIM ANKANDI
Përmbareus gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
Datë 03/07/2018, ditën e Martë, ora 16:00, përfundon ankandit i (i parë), për shpjen e pasurive të paluajtshme të llojt:
"Apartamenti" me siperfaqe prej 53,92 m². Rr "Ahmet Bektasht", pll.59 shk. 1.22,ap.6, në Kollonjë, në vlerën 1.600.000 lekë.
Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit ne hipotekë të debitorit Z. Bashkim Ilii Selaj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z. Ylli Koco Sotiri, banues ne Erseke, Kollonjë.
Ankandent zhvillohet pranë zyrsë së përmbareusit me sell lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI
Përmbareus gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
Datë 04/07/2018, ditën e Mërkurë, ora 16:00, përfundon ankandit i (i parë), për shpjen e pasurive të paluajtshme të llojt:
"Apartamenti" me siperfaqe prej 82 m², e ndodhur në Korçë, në vlerën 2.099.200 lekë.
Pasuria është lenë në garanci bankare për shlyerje kredie sipas kontrates për venien e sendit ne hipotekë të debitorit Z. Bashkim Ilii Selaj banues në Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit z. Alfred Selim Xhambazi banues në Korçë
Ankandent zhvillohet pranë zyrsë së përmbareusit me sell lagjen nr.3, Rruga "Avni Rustemi", nr.31 k.1, Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbareimore L.D.C
"Trulli + ndertese", me nr pasurije 31712, ZK 3428, vol 5, lq 3 me siperfaqe totale trulli 1.837 m² dhe siperfaqe ndertese 260.6 m² me adrese fshati Shtoji Rj, Shkodër. Regjistruar ne Z.V.R.P.P Shkodër ne emer te Zako Spaso Ajkoviq. Çmimi fillësar për shitje është 22.400.000 Leka.
Data e shpalljes 21.06.2018
Data e zhvillimit 13.07.2018 deri ne oren 16.00
Ankandit zhvillohet ne ambientet e Studios Permbareimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Gjermania e Holanda urojnë Shqipërinë e Maqedoninë, por kërkojnë më shumë punë

Ministri gjerman: Vendimi i BE-së, stimul për Shkupin dhe Tiranën

Holanda: Koha për rezultate konkrete kundër krimit e korrupsionit

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas, tha dje se vitin e ardhshëm mund të fillojnë bisedimet me Shqipërinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në një intervistë për "Deutch Welle", Maas u shpreh se vlerësohen arritjet e reformave në dyja vendet e Ballkanit Perëndimor. "Bashkimi Europian këtë javë ka marrë një vendim të rëndësishëm, duke filluar nga viti 2019 mund të fillojnë bisedimet me Shqipërinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ne jemi angazhuar shumë për këtë sinjal të fortë dhe udhërrëfyes, përmes të cilit vlerësohen arritjet e reformave në vitet e fundit", tha Heiko Maas. Maas u bëri thirrje politikanëve në Tiranë dhe në Shkup që këtë sukses të arritur ta vlerësojnë si stimul për të vazhduar me reformat. "Procesi i negociatave në Bruksel nuk ka qenë gjithmonë i lehtë, por ne jemi të gëzuar, që në fund u bë i mundur një kompromis i të gjitha 28 vendeve anëtare të BE-së. U bëj thirrje politikanëve në Tiranë dhe në Shkup, që këtë sukses ta vlerësojnë si një stimul për të vazhduar me impenjim reformat. Gjermania do të vazhdojë të mbështesë fuqimisht në këtë drejtim", u shpreh ministri i Jashtëm.

REAGIMI

Nënkohë Holanda, një nga vendet më euroskeptike për zgjerimin e Bashkimit Europian, ka uruar Shqipërinë pas vendimit të BE-së për hapjen e negociatave në 2019. Në një reagim në "Facebook", ambasada holandeze në Tiranë ka përcjellë qëndrimin e qeverisë ku inkurajohet Shqipëria për të vijuar rrugën e progresit dhe reformave. Qeveria holandeze thekson se përpjekjet e Shqipërisë janë njohur nga Evropa dhe se ky vendim është një hap gjigant në rrugën e anëtarësimit të BE-së. "Dëshirojmë të përgëzojmë Shqipërinë për progresin dhe reformat e rëndësishme të arritura, të cilat janë njohur nga Këshilli Europian", thuhet në reagimin e ambasadës në Tiranë. "Tashmë ka një udhërrëfyes të qartë për vijimin e rrugëtimit deri në qershor 2019. Ka ardhur koha për të arritur rezultate konkrete



Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Maas

në të gjitha nivelet në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe për të ecur përpara në reformën në drejtësi. Holanda i qëndron qasjes së saj strikte dhe të drejtë dhe është

të e gatshme të bashkëpunojë edhe më tej me Shqipërinë në lidhje me këto reforma kyçe në periudhën që vijon", u shpreh ambasada holandeze në Tiranë. Në vendimin e tij, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së u shpreh: "Këshilli mirëpret progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në ndjekjen e reformave që lidhen me pesë prioritetet kyçe: reforma e administratës publike, reforma e gjyqësorit, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe të drejtat e pronësisë. Ristrukturimi institucional i gjyqësorit është në vazhdim, si një gur themeli i një reforme gjithëpërfshirëse të drejtë-

VENDIMI

Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së i rikujtoi Shqipërisë se vendimi për të hapur negociatat do të jetë subjekt i përfundimit të procedurave parlamentare dhe miratimit nga Këshilli Evropian dhe do të pasohet pas kësaj nga konferenca e parë ndërqeveritare deri në fund të vitit 2019, në varësi të progresit të bërë.

sisë. Procesi i rivlerësimit për gjyqtarët dhe prokurorët (vetingu) ka filluar të japë rezultatet e para të prekshme, duke përfshirë edhe anëtarët e nivelit të lartë të gjyqësorit, nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit". Këshilli e inkurajon Shqipërinë që ta vazhdojë bashkëpunimin e saj të mirë me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit. Këshilli e inkurajon Shqipërinë që të mbështetet në progresin e deritanishëm dhe të ndjekë intensivisht reformat në drejtësi që synon rritjen e pavarësisë, llogaridhënies, profesionalizmit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, sidomos nëpërmjet avancimit të mëtejshëm të procesit të vetingut, i cili është vendimtar për suksesin e tij.

Hapet dega me e re Fibank Albania në Lezhë

Dega Lezhe është me e reja e hapur nga Fibank si pjese e strategjise se zgjerimit dhe rritjes te biznesit ne Shqiperi. Fibank Albania po zgjerohet ne tregun Shqiptar me mbeshtetjen e fuqishme te Grupit rajonal Fibank.

Strategjia e zgjerimit synon punesimin e kapaciteteve profesionale, kredidhënien dhe suportin per bizneset e mira si edhe ofrimin e te gjitha produkteve e sherbimeve bankare per klientet individve.



Ne vitin 2018 pritet nje vazhdimesi e zhvillimeve pozitive dhe nje rritje e metejshme e bazuar ne perpjekjet e vazhdueshme ne ofrimin e produkteve inovative dhe te pershtatura per cdo tip klienti.



Subjektet që i nënshtrohen tatim-fitimit deklarojnë 'online' dhe pa kosto

Ornela Manjani

Bizneset që janë subjekti i tatim-fitimit kanë kohë deri me 31 korrik për të depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit pasqyrat financiare vjetore, raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë dhe vendimin ligjor për miratimin e bilanceve. Përmes një njoftimi zyrtar, kjo Qendër u është drejtuar të gjithë subjekteve që janë regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim fitimi për t'i kujtuar se afati përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve është jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. QKB njofton se depozitimi i dokumenteve të sipërcituara mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania, duke ndjekur të gjitha hapat e procedurës për kryerjen e aplikimit; Ndërkohë që formati elektronik i ruajtjes së pasqyrave financiare, duhet të jetë në PDF, ku çdo dokument të ngarkohet si një dokument i vetëm.

NJOFTIMI

Qendra Kombëtare e Biznesit njoftoi se të gjithë bizneset që janë të regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim-fitimi duhet të depozitojnë pranë saj bilancin dhe raportin e auditit sipas parashikimeve në ligj deri në datë 31 korrik 2018. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi ligjor QKB-së i lind e drejta që të gjobisë bizneset 15 000 lekë ndërkohë që saktëson se depozitimi i dokumenteve mund të bëhet vetëm online përmes sistemit të albania dhe individit aplikues duhet të ketë kartën e identitetit. Shërbimi për këtë kryhet pa pagesë ndërkohë që subjektet me administrator të huaj dhe shoqëritë e kursim kreditit do të vijnë që të kryejnë aplikimet përmes sporteleve të QKB. "Të nderuar subjekte tregtare. Mbështetur në ligjin

Depozitimi i detyrueshëm i bilanceve QKB, bizneseve: Afat deri më 31 korrik

Njësitë duhet të dorëzojnë pasqyrat financiare



Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, neni 43, pika (a) subjektet që kanë detyrimin të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, kur mbajta e tyre është e detyrueshme, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto

dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Detyrimin për depozitimin e dokumenteve të sipërcituara e kanë subjektet që janë regjistruar me përgjegjësi tatimore tatim fitimi, të cilët duhet të dorëzojnë pranë QKB-së: Pasqyrat financiare vjetore të skanuara në format PDF; Raportin e auditimit dhe ecurisë së veprimtarisë (kur mbajta e tyre është e detyrueshme); Vendimin për miratimin e pasqyrave financiare (sipas kërkesave ligjore). Afati i fundit i dorëzimit është data 31 Korrik 2018. Depozitimi i dokumenteve të sipërcituara mundësohet vetëm nëpërmjet aplikimit online në portalin qeveritar e-albania, duke ndjekur të gjitha hapat e procedurës për kryerjen e aplikimit.

"Klienti misterioz" vlerëson performancën e institucioneve publike në ofrimin e shërbimeve

Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorja Rajonale e Tatimeve Korçë dhe Qendra e Integruar ADISA Krujë u vlerësuan me çmime për cilësinë e performancës në ofrimin e shërbimeve publike. Në ambientet e Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD) të Kryeministrit u zhvillua ceremonia e ndarjes së "Çmimeve të Ekselencës për Shërbimet Publike 2018", ku ishte e pranishme zëvendëskryeministria Senida Mesi, partnerë ndërkombëtarë, donatorë dhe përfaqësues të rëndësishëm të institucioneve të ndryshme private e publike. "Klienti Misterioz", me anë të vizitave pranë institucioneve të ndryshme publike, gjatë periudhës së studimit ka testuar nëse shërbimi i ofruar plotësoni standardet e deklaruara, ka vëzhguar aftësitë ndër personale të punonjësve, si dhe ka vlerësuar performancën e tyre duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta gjatë marrjes së shërbimit. Studimi është kryer në 7 institucione kryesore dhe tek ADISA (Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara). Janë zhvilluar plot 344 vizita në intervale të ndryshme kohore dhe janë aplikuar 14 skenarë nga "klienti" të ndryshëm. "Deri në dhjetor 2018 do të kemi trajnuar 2500 punonjës të administratës publike. Do të rishohim edhe procedurat e vlerësimit të performancës e rritjes në detyrë duke i lidhur ato ngushtë me përformimin e kapaciteteve të punonjësve përmes trajnimeve dhe kualifikimeve", ndër të tjera u shpreh zëvendëskryeministria Mesi.



Fondet shkojnë për bizneset, kulturën dhe infrastrukturën

Investim 113 mln euro për turizmin

Shqipëria do të investojë 113.3 milionë euro në një projekt që synon të zhvillojë edhe turizmin që nuk lidhet me bregdetin. Nga ky program pritet të përfitojnë në infrastrukturë të lidhur me turizmin qarqet e përcaktuara të Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës; ndërsa investimet në fushën e transportit do të bëhen në të gjithë vendin. Për financimin, do të përdoret një grant prej 40 milionë eurosh nga Bashkimi Europian, ndërsa BERZH njofton se po shqyrton një

kredi prej 60 milionë eurosh, e ndarë në dy lote. Synimi i programit është të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit të turizmit në vend, duke u fuqizuar në zhvillimin e infrastrukturës, të pikave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe përmes mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të mesme (SME), SME-të dhe mikrobizneset aktive në zinxhirin e turizmit do të mund të përfitojnë edhe nga financime nga bankat e nivelit të dytë në vend.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

- 1- "Pyll + Kullote" me sip. 280.000 m2, Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **4.800.320 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane.
- 2- "Pyll + Kullote" me sip. 95.000 m2, Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur ne Poro, Vlore. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **1.628.680 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane.
- 3- "Truall + Ndërtim" me sip.3.250 m2 nga kjo 1474,5 m2 ndërtesë me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **545.440 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane.
- 4- Për pasurinë me Nr.578/184, vol.13, fq.216, Zk.3385, me sip.1.270 m2 me adresë Shkallur, Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **35.560 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane
- 5- Për pasurinë me Nr.1/973+1-9, vol.41, fq.85, Zk.8513, me sip.119,2 me adresë Rr."Muco/15", Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **40.040 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane
- 6- Për pasurinë me Nr.160/51, vol.16, fq.72, Zk.2574, me sip.2.470 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **138.320 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane
- 7- Për pasurinë me Nr.160/50, vol.6, fq.71, Zk.2574, me sip.7.330 m2 me adresë Xhafzotaj, Durrës. Kjo pasuri eshte hipotekuar ne favor te Banka Raiffeisen sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte **941.360 Euro**. Ankandi zhvillohet date **26.07.2018 ora 16.00** ne adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratar", K.6.Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje uniforma e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, **me fond limit 2.457.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje uniforma e veshje pune për punonjësit e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **31 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

"Parësore mbetet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve"

Raporti i DASH për trafikimin e qenieve njerëzore, reagon ministri Xhafaj

Pas publikimit të raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit ku thuhet se Shqipëria nuk përmbushte standardet minimale për eliminimin e trafikut njerëzor, ka reaguari ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj. Gjatë aktivitetit "Thirrja për veprim - Bashkë kundër skllavërisë moderne dhe trafikimit të personave", ministri Xhafaj tha se qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa hapa kundër këtij fenomeni. Ministri theksoi se kjo është një ndër prioritetet kyçe të qeverisë shqiptare, dhe se

REAGIMI

"Teksa shqipton fjalën "skllavëri", tingëllon pak anakronike kjo, sepse më shumë se 150 vjet më parë, shumica e vendeve në botë, e kanë zhdukur këtë fenomen, në kuptimin dhe format e asaj kohe, por edhe sot sipas statistikave zyrtare të organizatave ndërkombëtare, miliona njerëz në të gjithë botën jetojnë në kushtet e skllavërisë moderne", - theksoi Xhafaj .

realizimi i këtij projekti kërkon bashkëpunim rajonal dhe kombëtar. Parësore sipas ministrit Xhafaj, është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. "Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, punës së detyruar,

skllavërisë moderne, vazhdojnë të përbëjnë një nga sfidat kyçe të qeverisë shqiptare, Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit dhe gjithë strukturave të tjera, me detyra dhe përgjegjësi të drejtpërdrej-

ta në këtë drejtim. E vërtetë, teksa shqipton fjalën "skllavëri", tingëllon pak anakronike kjo, sepse më shumë se 150 vjet më parë, shumica e vendeve në botë, e kanë zhdukur këtë fenomen, në kuptimin dhe format e asaj kohe, por edhe sot sipas statistikave zyrtare të organizatave ndërkombëtare, miliona njerëz në të gjithë botën jetojnë në kushtet e skllavërisë moderne. Është përgjegjësia jonë e përbashkët për trajtimin, reagimin dhe angazhimin ndaj fenomeneve të tilla të papranueshme për sho-



qëritë demokratike dhe shtetin e së drejtës. Është koha për më shumë fokus në çështjet e tilla, për vullnetet dhe strategji më të qarta, por mbi të gjitha për përgjegjësi dhe veprime konkrete për investigimin dhe ndëshkrimin e dukurive të tilla. Ka nevojë, gjithashtu, për më shumë bashkëveprim midis institucioneve shtetërore, por edhe midis tyre dhe të organizatave të shoqërisë civile, të cilat

kanë një rol të rëndësishëm në këtë fushë dhe disa prej tyre që i shoh prezente edhe në këtë sallë, kanë bërë një punë shumë të mirë në këtë fushë. Natyrisht është mirë, kur punohet për projekte që japin rezultate konkrete, dhe jo për projekte që kthehen si qëllim në vetvete, për të prodhuar dokumente për projektin e radhës, siç ka ndodhur me disa raste", -u shpreh ministri Xhafaj.

Pista e hetimit: Borxhet e pashlyera dhe atentati i ndodhur në 2017-ën

Plagosja e trefishtë në "Kinostudio", zbardhet dëshmia e Rivelino Mumajesit

36-vjeçari: Nuk i pashë dy 2 atentatorët, s'e di motivin e sulmit

Ina Allkanjari

Dytë ditë pas përplasjes me armë zjarri mes dy grupe rivale, në zonën e "Kinostudios" në kryeqytet, dalin në dritë të tjera detaje. Ndërsa ngjarja mbetet ende pa autor, mësohet se pista kryesore mbi të cilën po heton policia është vijimi i konfliktit të marsit të 2017, ku rezultoi i përfshirë një prej vëllezërve që mbeti i plagosur mesnatën e së enjtes, Rivelino Mumajesit. Në ngjarjen e ndodhur rreth një viti më parë ku mbeti i plagosur shtetasi Eduard Duka, dyshohet se 36-vjeçari Mumajesit i dha ndihmë atentatorëve, duke qenë se ishte banor i zonës. Ndërkohë një pistë tjetër që po heton policia për të zbardhur plagosjen e 3 personave në kinostudio më 27 qershor është ajo e pazareve të drogës dhe një borxh i pashlyer nga vëllezërit Rivelino e Juxhin Mumajesit. Sakaq uniformat blu kanë marrë në pyetje ditën e djeshme 24-vjeçarën Juxhin Mumajesit, gjendja shëndetësore e të cilit është stabilizuar. Mësohet se para oficerëve të policisë ai është shprehur se nuk i ka parë dy 2 atentatorët dhe se nuk e di motivin e pse këta të fundit qëlluan me armë. Ibrahim Durollari, i riu që mbeti i plagosur ka dalë nga koma, por pavarësisht kësaj, ai ndodhet në reanimacion në gjendje të rëndë. Bëhet me dije se 28-vjeçari ka marrë disa plumba në bark, të cilat i kanë prekur organet. Ndërkohë, dy vëllezërit, Rivelino dhe Juxhin Mumajesit ndodhen jashtë rrezikut për jetë. Ata kanë marrë dëmtime nga plumbi në zonën e gjymtyrëve të poshtme. Në ditët në vijim do të merren në pyetje dhe të 2 plagosurit e tjerë, kjo pasi pritet



Vendi ku ndodhi ngjarja

përmirësimi i gjendjes së tyre shëndetësore për të marrë deponimet. Bëhet me dije se policia vijon të shoqërojë persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen dhe po këqyr kamerat e sigurisë në zonë për të bërë të mundur identifikimin e autorëve. Kujtojmë se të tre të plagosurit janë me precedent të mëparshëm penal në fushën e vjedhjeve dhe të shitjes së narkotikëve. Për shkak të këtyre precedentëve vëllezërit Rivelino e Juxhin kanë ndërruar mbiemrin e tyre nga Hamajezi në Mumajesit.

NGJARJA

Mesnatën e 27 qershorit në rrugën "Aleksandër Moisiu", në një lokal bastesh kanë mbetur të plagosur me armë zjarri

nga persona ende të paidentifikuar, shtetasit Juxhin Mumajesit 24 vjeç, Rivelino Mumajesit 36 vjeç dhe Ibrahim Durollari 28 vjeç. Ka dyshime se 2 persona ende të paidentifikuar nga policia, pjesëtarë të një grupi rival iu afruan personave që mbetën të plagosur dhe hapën zjarr ndaj tyre. Edhe këta të fundit iu kundërpërgjigjen po duke qëlluar me armë zjarri. Burime nga policia thanë se motivi i kësaj ngjarje lidhet me tregun e narkotikëve, dhe përplasje ka ndodhur mes 2 grupeve rivale për territorët e shitjes. Vetëm disa orë pas përplasjes me armë mes dy grupeve rivale, uniformat blu arrestuan një person. Ai është 29-vjeçari

Ervis Bano, dhe akuzohet për veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Dyshohet se Bano ka marrë serverin e kamerave të një biznesi në zonën ku ndodhi ngjarja, dhe ka tentuar ta dëmtojë, për të fshehur pamjet. Gjithashtu, mësohet se një nga personat e plagosur, 36-vjeçari Rivelino Mumajesit, nuk është një emër i panjohur për policinë. Kjo pasi ai në mars të 2017-ës është përfshirë në plagosje me armë zjarri të shtetasit Eduard Duka. Burime policore thanë se dyshohet se në ngjarjen e ndodhur rreth një viti më parë, Rivelino Mumajesit i dha ndihmë atentatorëve, duke qenë se ishte banor i zonës. Sakaq hetuesit sqarojnë se të plagosurit, para disa ditësh kanë bërë një sherr me dy persona, të cilët dyshohet se mund të jenë autorët. Rivelino Mumajesit, Juxhin Mumajesit, si dhe Ibrahim Durollari janë të shtetur nga policia si persona që merren me shitjen dhe shpërndarjen e lëndëve narkotike.

Ndërkohë menjëherë pas vendosjes së shiritit të sigurisë dhe fiksimit të provave nga grupi hetimor, janë sho-

SHKURT

Gjykatat drejt kolapsit, 11 kryetarë pa mandat

11 kryetarë gjykatash që u ka mbaruar mandati kanë deponuar kërkesat e tyre në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, ku shprehin interesin për të vijuar sërish në këtë detyrë. Sipas shkresës në fjalë, bëhet e ditur se 11 prej këtyre gjyqtarëve u ka mbaruar mandati, ndërsa 11 prej kryetarëve të tjerë u përfundon në 6-mujorin e dytë. Ndonëse KLD nuk ka kompetencë që të kryejë zëvendësimin, ajo po shqyrton delegimin e mandateve për gjyqtarët. Kjo për faktin se duhet të krijohet institucioni i KLGJ-së, duke futur në ngrëje edhe gjykatat. Konkretisht kryetarët e gjykatave që u ka mbaruar mandati janë: Artan Çupi-Kryetar i Gjykatës së Matit (11.10.2013); Kastriot Selita-Kryetar i Administrativës Tiranë (28.10.2013); Fuat Vjerdha-Kryetar i Apelit në Shkodër (17.01.2014); Entela Priifti-Kryetare e Apelit në Korçë (17.01.2014); Dritan Banueshi-Kryetar i Apelit në Gjirokastrë (17.01.2014); Alma Liçaj-Kryetare e Apelit në Vlorë (17.01.2014); Petrit Çeno-Kryetar i Apelit në Durrës (11.04.2014); Halil Vani-Kryetar i Gjykatës në Dibër (11.04.2014); Altun Çela-Kryetar i Gjykatës në Sarandë (28.25.2014) dhe Sandër Simoni-Kryetar i Gjykatës së Krimeve të Rënda.

qëruar në Komisaratin nr.4 rreth 23 persona, të cilët janë cilësuar si dëshmitarë okularë, si dhe persona të tjerë të cilët dyshohet se kanë dijeni për ngjarjen. Uniformat blu kanë ushtruar kontroll në banesat e disa prej të dyshuarve si au-

torë. Ende nuk dihet sesa armë janë përdorur; ndërkohë është bërë këqyrja e vendngjarjes, ndërsa është vënë në rrethim zona. Po vijon puna për identifikimin dhe kapjen e autorëve, si dhe dokumentimin e plotë të kësaj ngjarje.

SHPALLJE ANKANDI
Datë 02.07.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e parë për përcaktimin e paluajtshme të debitorit Shoqëria "VIGAND Konstruktion" sh.p.k.

-Njësi me sipërfaqe 265, 22 m², nr. i pasurisë 8/440-N12, zona kadastrale 8150, vol. 47, faza 208, adresë: Rruga "Petro Nini Luarasi", Tiranë.

Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 339 482 (treqind e tridhjetë e nëntë mijë e katërqind e tërtdhjetë e dy) EUR.

Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbartimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përmbartimore "Best2018"

Me datë 3 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 lek kjo zyra përmbartimore do zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë së shoqërisë "Konstanti Siga".

Apartamenti/zyra që do të shitet ndodhet në ZK 8310, Rr"Orlani Hoxha", Tiranë (kati 7 i ndërtesës, mbi zyrat e Bankes NBG).

Prona është e debitorit e nuk rëndohet nga asnjë detyrim tjetër civil.

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi është 11.772.000 lekë.

Cmimi fillestar edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditës.

P.s. Cytelant/shoqëritë që deshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të cmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurohet duhet të jetë e dorëzuar në BKT, nr. llogarise Saimir Hasa/PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLJALLA)

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-4000

E-mail: best.2018@permbartues.al, web: www.permbartues.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
Zyra përmbartimore "Best2018"

SHPALLJE ANKANDI

Me datë 16 korrik 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 lek kjo zyra përmbartimore do zhvillohet ankand për shitjen e pasurisë nr.58/58, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Trruallë që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshjeje sipërfaqerje.

Prona është e vëllezërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 570020 Euro.

Cmimi mund të llogaritet edhe në lek sipas kursit të këmbimit ditës.

Oferuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbartimore 10% të cmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000

E-mail: best.2010@permbartues.al, web: www.permbartues.al

Ervis Kuçi

FIER

Njëzet ditë pas vrasjes barbare në Torino të Italisë, ka mbërritur në Shqipëri trupi i pajetë i 21-vjeçares Anxhela Meçani. Sipas policisë dhe mediave të vendit fajn, mbrëmjen e 10 qershorit e reja u hodh nga një makinë në lëvizje dhe si pasojë e plagëve të marra ndërroi jetë në spitalin Santa Croce në Moncalieri. Familjarët e kanë pritur mes lotëve e dhimbjes trupin e pajetë të vajzës, ndërsa kanë bërë thirrje për zbardhjen e plotë të ngjarjes, si dhe dënimin maksimal të autorit të krimit. Meçani u varros pasditen e djeshme në fshatin Baltz të rrethit të Fierit, ku prehet edhe nëna e saj, e cila ndërroi jetë 5 muaj më parë. Trupi i 21-vjeçares mbërriti në Fier pas apelit për ndihmë të familjarëve, të cilët deklaruan se nuk kishin mundësi financiare që ta sillnin në Shqipëri. Ndërkohë, familjarët e viktimës pohan se falë ndihmës së emisionit "Me zemër të hapur" në "Neës 24", një agjenci funerale nga Shijaku u sollti trupin e vajzës. "Falënderojmë 'News 24' për ndihmën që na dha. Agjencia funerale sollti trupin pa asnjë kosto. Autori të dënohet për krimin, do ta ndjekim çështjen deri në fund", u shprehën familjarët.


VARRIMI
Vrasja makabre e 21-vjeçares Anxhela Meçani ka tronditur tejet familjarët dhe të afërmit e saj, të cilët i kanë dhënë lamtumirën e fundit. Sapo ka mbërritur arkivoli me trupin e pajetë, motra e vogël, babai, Dritan Meçani dhe gjyshi, Isa Veizaj kanë shpërrthyer në lot. Të pafuqishëm përballë kësaj fatkeqësie, e dyta në pak muaj (Anxhela humbi nënën 5 muaj më parë), familjarët e viktimës kërkojnë që për rastin e saj të bëhet drejtësi. Ata thanë se trupi i Anxhelës ishte i dëmtuar dhe me shenja, ndërsa akuzojnë autoritetet italiane se nuk kanë sjellë një ekspertizë për të mësuar shkaqet e vdekjes. Pengu më i madh i tyre është se nuk dinë kush është autori i kësaj ngjarjeje. "Rashë nga makina", ka mundur të thotë Anxhela mbrëmjen e 10 qershorit kur u transportua në spital, aty ku dhe mbylli sytë krejt e vetme. Shumicën e detajeve familjarët i kanë mësuar nga mediat italiane. Dritan Meçani deklaroi pas ngjarjes se e bija ishte larguar nga Fieri me një djalë. Ajo më pas ishte martuar me një burrë të madh në moshë, por që nga ajo ditë nuk ishte kthyer kurrë në shtëpi, pasi nuk kishte dokumente. Madje, e reja nuk kishte mundur të kthehej as 5 muaj më parë në Fier, kur i vdiq e ëma.

NGJARJA
Shqiptarja Anxhela Meçani u hodh nga një makinë në ecje e sipër në Torino dhe më pas ndërroi jetë në spital për shkak të plagëve të shumta. 21-vjeçares i është gjetur një dokument identi-

Dritan Meçani: Krimineli që i mori jetën sime bije të dënohet maksimalisht

U vra barbarisht në Itali, mbërrin në Fier trupi i pajetë i Anxhela Meçanit

Dhimbje e lot, 21-vjeçarja varroset pranë të ëmës



21-vjeçarja Anxhela Meçani



Gjyshi Isa Veizaj dhe babai i viktimës Dritan Meçani, duke folur për "GSH"

fikimi në rrobat që mbante veshur, por edhe telefoni celular, të cilin e kanë sekuestruar tashmë hetuesit e çështjes. Referuar dokumenteve të saj të identifikimit, Anxhela Meçani rezultoi të ketë lindur në Fier më 1 mars 1998. Në Itali ka mbërritur më 17

dhjetor të vitit që shkoi. Ajo ka ikur me një djalë nga Fieri dhe më pas atje është martuar me një italian të madh në moshë. Zyrtarisht ajo banonte në Ravenna, në një apartament në mes të qendrës historike, pak hapa larg nga "Piazza del Popolo". Mediat ital-



Ceremonia mortore

HETIMI

"Republica" raportoni pas ngjarjes se Anxhela Meçani ndërroi jetë në spitalin Santa Croce në Moncalieri. Sipas mediave të vendit fajn, vajza shqiptare, e cila dyshohet se ishte punonjëse seksi, është hedhur nga dritarja e një makine, e cila ishte në ecje. Për pasojë, ajo ka mbetur e plagosur rëndë, ndërsa nuk ka mundur t'u mbijetojë plagëve të marra. Pikërisht në këtë pistë po hetohet edhe nga policia.

BABAI I VIKTIMËS

"Vajza ime është dhunuar dhe më pas është vrarë barbarisht. Krimi ishte i tmerrshëm, ndaj kriminali duhet të marrë dënimin maksimal. Dhimbja që më është shkaktuar është shumë e madhe, sidomos mua që jam me fëmijë të vegjël akoma. Unë jam i bindur që para vrasjes, ime bijë është keqtrajtuar, sipas filmimeve që kemi parë. Ne do e ndjekim çështjen deri në fund, deri sa të bëhet drejtësi".

iane nuk e përjashtojnë mundësinë e gjetjes së një partneri tjetër, por prej disa javësh ajo ishte rishfaqur sërish në Torino. Që nga fillimi i muajit maj, vajzat që sheshin trupin me 30 euro rreth zonës së Stupinidit e kujtojnë atë si "njëra prej të rejave" në atë

SHKURT

U kapën me drogë në makinë, arrestohen 3 të rinj nga Tirana

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka sekuestruar 31 kg lëndë narkotike, ndërsa në pranga kanë rënë 3 të rinj. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Labinoti" u arrestuan shtetasi Klevis Metani, 25 vjeç, Rexhino Elezi, 27 vjeç si Redian Vata, 31 vjeç, të tre banues në Tiranë. Sipas policisë, pas kryerjes së hetimit me metoda speciale u bë e mundur sekuestri i sasisë së drogës në fshatin Labinot-Fushë, në një automjet të marrë me qira. Ndërkaq, vijojnë hetimet për identifikimin e bashkëpunorëve të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet i kaluan prokurorisë për veprime të mëtejshme.

Vrasja e avokatit Zafeiropoulos, letra fundos shqiptarin

GREQI - Autori i vrasjes së avokatit të njohur grek Mihalis Zafeiropoulos në zyrën e tij më 12 tetor 2017 është "vetëzbuluar" nga një letër që i ka lënë policisë. Ai është Eno Aleksandro Mata, ndërsa policia greke dyshon se është autori i dytë i vrasjes së Zafeiropoulos. Dy ditë më parë Mata ka marrë pjesë në grabitjen e një argjendarie bashkë me 5 shqiptarë të tjerë. Mediat greke raportojnë se ai i ka lënë një pusullë policisë ku shkruante: "Në vrasjen e avokatit Zafeiropoulos jemi të dy viktimë. Jam hajdut, jo ekzekutues". Avokati Zafeiropoulos u vra nga dy shqiptarë më 12 tetor 2017 në Athinë. Pas ngjarjes, policia arrestoi shqiptarin Mikel Brahimaj, i cili e pranoi krimin, ndërkohë që shpalli në kërkim një tjetër shqiptar.

Arrestohen 6 persona, mes tyre edhe një grua

Kryen mbi 100 grabitje në Spanjë, shkatërrohet grupi shqiptaro-ekuatorian

SPANJË - Policia spanjolle ka shkatërruar një grup kriminal, që ka kryer qindra plaçkitje në shtëpitë në provincën e Gironas, ku kanë marrë para, stoli dhe pajisje elektronike. Janë 6 të arrestuar me origjinë shqiptare dhe ekuadoriane, por edhe një grua. Policia e Barcelonës dhe Bidalonas, të cilët po hetojnë krimet e grupit kriminal thotë se ata kanë kryer 102 grabitje me forcë në banesa. Mediat vendëse kanë dhënë detaje nga operacioni, duke zbuluar edhe mënyrën e funksionimit të grupit. Ato shkrua-

jnë se grupi ishte i përgatitur fizikisht. Zëvendësprokurori Charles Martinez i Divizionit të Hetimeve Kriminale (DIC) shpjegoi mënyrën e djeshmë se grupi kriminal ishte shumë i specializuar dhe se "modus operandi" i tij kërkonte një përgatitje të madhe fizike. Mësohet se ata përgatiteshin, duke shkuar në male, ndër të tjera. Pikërisht pas disa grabitjeve vitin e kaluar, policia evidentoi të njëjtën skemë të përdorur, çka vërtetoi dyshimet se ishte e njëjta dorë. Skuadra Mossos u vu në ndjekje të tyre, por arrestimi ishte i vështirë,

pasi autorët përdornin automjete të ndryshme për të kryer vjedhjet, me të cilat lëviznin në Katalunja duke përdorur teknika për t'i shpëtuar policisë. Shtëpitë e zgjedhura ishin ato që dukeshin të shtrenjta dhe pranë zonave të pyllëzuara, ku mund të fshiheshin dhe të ishin në gjendje të iknin pa ngritur dyshime. Por autorët nuk shfaqeshin asnjëherë para ngjarjes në vendin e grabitjes. Martinez tha se ata e studionin secilin shtëpi dhe hynin pothuajse pa dëmtuar, ose më së shumti të detyruar thyenin një dritare ose hap-



nin derën me një kaçavidë. Pavarësisht se ishte një grup prej 10 personash, plaçkitjet gjithmonë i kryenin në grupe prej tre vetash: njëri priste në makinë larg shtëpisë në fjalë dhe dy të tjerat plaçkitnin në shtëpi kur nuk kishte asnjë të pranishëm, gjithmonë në muzg. Oficerët e policisë kanë sekuestruar bizhuteri, karta

SIM, telefona dhe pajisje elektronike, si dhe mjete dhe rroba të përdorura për vjedhje. Më 27 qershor, të arrestuarit dolën para gjykatës, e cila vendosi të lërë në burg 6 prej tyre dhe liri dy të tjerë, edhe pse hetimi është ende i hapur dhe arrestimet e mëtejshme nuk janë përjashtuar.

Fatjona Mejдини

Me sytë nga gjykatat: Abuzimet e kontratave koncesionare shpresohet të ndalen me një mënyrë të re

Nga ndërtimi i inceneratorit për djegien e mbetjeve në Fier, te shitja e shtëpive të pushimit, dikur pronë e përbashkët në Divjakë, konsultimi me qytetarët, ndonëse detyrimi ligjor është braktisur përfundimisht.

Në mars të vitit të shkuar, kur disa shpallje të ngjitura në shtyllat e enërgjisë elektrike në fshatin Vërrë, rreth 12 kilometra në verilindje të Fierit, do t'iu kërkonin banorëve takim, asnjë nuk e kishte menduar se nga ky çast jeta e tyre do të përfshihej në një spirale pasigurie.

Por, shumë prej tyre e ndjenë këtë, pasi shkelën në pragun e një lokali fshati, ku përfaqësuesit e një kompanie të panjohur, iu kërkuar mbështetje për ngritjen e një inceneratori që do të digjte mbetjet e qarkut të Fierit në më pak se 1 kilometër distancë nga shtëpitë dhe tokat e tyre.

Landi Golemi, një banor i zonës që merret me bujqësi, kujton se së bashku me 60 të tjerë, pasi kishin dëgjuar arsyen e takimit, ishin larguar të revoltuar nga salla duke thënë: "Ju nuk keni për t'ia arritur kurrë këtë qëllimi."

Sot, një vit e gjysmë më pas, qëndrimi i tyre është lëkundur nga makinat e tonazhit të rëndë, që vijojnë punën për ngritjen e inceneratorit brenda 11 hektarëve të rrethuar me tela hekuri.

Janë të panumërta protestat e bëra nga rreth 1100 banorët e fshatit Vërrë që nga ajo kohë. Revolta u ndez nga fakti se askush nuk i njoftoi paraprakisht për ngritjen e këtij impianti dhe frikës se ndotja që ai do të shkaktojë, do t'i detyrojë të largohen përfundimisht nga fshati.

Ata ndihen të tradhtuar nga Bashkia e Fierit, pasi besojnë se, nëse përfaqësuesit e këtij institucioni do t'i respektonin sadopak, do të merrnin mundimin të ndanin me ta planet për ndërtimin e kësaj veprë.

Rreth 35 kilometra në veriperëndim të fshatit të tyre, banorët e Divjakës e kanë provuar kohë më parë se çfarë sjell vendimmarrja e pushtetit vendor me atë që ajo prek.

Pronat e kësaj bashkie të vogël në brigjet e detit Adriatik u dhanë me qira për qëllime turistike në vitin 2010, përmes një procedure të konsideruar nga banorët dhe këshilltarët bashkiakë si jo transparente.

Por ky ishte vetëm fillimi. Në vitin 2013 katër nga këto ndërtesa kryesore në plazh, pronë e Bashkisë së Divjakës, u privatizuan përmes një procedure të konsideruar nga stafi i bashkisë aktuale si jashtë çdo logjike ligjore, pasi pronari real i këtyre pronave nuk u përfshi në këtë proces.

Mungesa e transparencës dhe shpërfillja e interesave lokale kanë sjellë revoltë në Vërrë dhe humbje të besimit ndaj institucioneve në Divjakë.

Të gjithë tashmë i kanë sytë nga gjykatat, me shpresën se ato do të mund të vendosin në vend drejtësinë dhe të ndihmojnë në kthimin e besimit në institucione dhe formimin e kohezionit social në komunitetet lokale.

NË FIER DHUNA ZËVENDËSOI KONSULTIMIN PUBLIK PËR INCENERATORIN

Hija e një inceneratori, i cili do të digte plehurat e qarkut të Fierit dhe do të prodhonte energji elektrike përmes këtij procesi, kishte kohë që vërtitej në zonat periferike të qytetit.

Lajmi për ndërtimin e tij u përhap në fillim të vitit 2016 duke krijuar ankth dhe pasiguri te banorët dhe vendimmarrja nuk vonoi. Në tetor, Ministria e Mjedisit lidhi një kontratë koncesionare me konsorciumin *Integrated Technology Waste Treatment*, Fier sh.p.k. për ndërtimin e impiantit.

Vendndodhja e përcaktuar në kontratë ishte Portëza, një fshat 5 kilometra në jug të Fierit dhe banorët e zonës menjëherë nisën protestat kundër vendimit.

Por brenda dyerve të mbyllura, vendndodhja ku ishte parashikuar të ngrihej in-



eneratori kishte ndryshuar dhe tashmë fshati Mbrostar, në veri të Fierit, katër kilometra nga qendra e qytetit, shihet si më i përshtatshëm për ngritjen e tij. Banorët e Mbrostarit nisën gjithashtu të protestojnë.

Saga e vendimmarrjeve të pakonsultuara vijoi dhe vetëm në mars të vitit 2017 u kuptua se vendndodhja përfundimtare e impiantit do të ishte fshati Vërrë. Protestat e banorëve të kësaj zone nuk munguan, por pavarësisht kësaj, vendimi mori vullën e Këshillit Kombëtar të Territorit, drejtuar nga kryeministri Edi Rama në tetor 2017.

Banorët e zonës kërkuar me çdo formë të informoheshin për këtë projekt, për të cilin mendojnë se do të shkaktojë shëndetin e tyre dhe traditën bujqësore, të ngritur me shumë mund në këtë zonë gjatë tri dekadave të fundit.

Qendra *Open Doors*, në kuadër të projektit *KONCESCAN* për monitorimin e disa koncesioneve në vend, del në përfundimin se, moskonsultimi i banorëve të Vërrisë për këtë nismë me rëndësi jetike për ta është një shkelje flagrante ligjore e Bashkisë së Fierit dhe Ministrisë së Mjedisit.

Projekti u realizua gjatë periudhës maj 2017-prill 2018 dhe u mbështet nga *Leviz Albania*.

Raporti i monitorimit thekson se këto autoritete, duke përjashtuar banorët nga konsultat, kanë shkelur Kushtetutën e vendit, e cila garanton transparencë; Kodin e Procedurave Administrative; ligjin për të Drejtën e Informimit dhe atë të Vetëqeverisjes Vendore.

inceneratorit dhe mospërgjigjen e bashkisë kur ajo kërkonte informacion.

"Ne nuk e dimë se çfarë efektesh ky impiant do të ketë në jetët tona. Nuk kemi lënë formë proteste pa zhvilluar dhe ajo që kemi marrë mbarsht është vetëm dhuna", - theksoi ajo.

Si pasojë e protestave të vazhdueshme, rreth 15 banorë të Vërrisë u referuan nga policia e Fierit në prokurori.

"Unë sot trajtohem si një kriminel për arsyen e thjeshtë se protestoj për të mbrojtur jetën dhe të ardhmen e fëmijëve të mi", - theksoi Vladimir Biti, banor i zonës, që ende vërtitet dyerve të gjykatës i proceduar si pasojë e protestës së tij.

Situata në të cilën gjenden banorët bëhet më e vështirë, në një kohë kur ekspertët mjedisorë theksojnë se ngritja e veprave të tilla është e shoqëruar me efekte negative.

Bo Leckner, profesor në departamentin e Mjedisit dhe Teknologjisë së Energjisë në universitetin Chalmers në Suedi, është i mendimit se, përgjithësisht inceneratorët, sipas standardeve të Bashkimit Europian, ndonëse nuk janë zgjidhje perfekte për menaxhimin e mbetjeve, janë të pranueshëm.

Por ai theksoi se një nga aspektet më negative të tyre lidhet me gazrat e lëshuara në ajër nga përpunimi i mbetjeve dhe vendosja e filtrave të teknologjisë së fundit është e vetmja garanci për të pasur një ndikim sa më të vogël në mjedis.

"Vendosja e një teknologjie të tillë sjell një kosto, të cilën kompania që zotohet për ngritjen e inceneratorit duhet ta paguajë. Sugjeroj që të zbatohen kërkesat dhe kufijtë e përdorur nga vendet e Bashkimit Europian për reduktimin e substancave të dëmshme nga vepra të tilla, pavarësisht faktit se Shqipëria nuk është ende anëtare e BE", - theksoi ai.

Profesor Leckner, gjithashtu solli në vë-

"Nga të dhënat e sondazhit rezultojnë se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve janë aspak, pak dhe disi të kënaqur me qëndrimin e bashkisë në lidhje me kontratën koncesionare, duke vënë në dukje frikën që pjesëmarrësit kanë në lidhje me abuzimet ligjore



mbi kontratën koncesionare", - theksohet në raport.

Bashkia e Fierit dhe Ministria e Mjedisit, të pyetura nëse kishin kryer konsultime me banorët e zonës Vërrë për ngritjen e inceneratorit, nuk kthyen përgjigje deri në kohën e publikimit të këtij shkrimi.

Por Lena Tashi, banore e fshatit Vërrë, nuk i ka harruar shkopinjat e gomës që pati marrë nga policia, teksa protestonte në janar të vitit 2018 kundër vendimit të ngritjes

mendje nevojën për një trajtim special të hirit të akumuluar gjatë djegies së mbetjeve, duke e konsideruar atë një substancë me rrezik të lartë.

Por ekspertët në Tiranë ngrenë alarmin se të dhënat e deritanishme tregojnë se teknologjia në të nuk do të jetë ajo e standardeve europiane, duke sjellë një rrezik të madh për banorët.

Përfaqësuesi i Aleancës *Kundër Importit të Plehrave*, AKIP, Lavdosh Ferruni, thek-



son se kostoja e planifikuar për ngritjen e inceneratorit të Fierit është disa herë më e ulët se ajo me të cilën vepra të tilla ngrihen në Europë.

"Kjo gjetje të çon në konkluzionin se për ndërtimin e tij mund të përdoret teknologji e vjetër, stock ose me të mund të ndodhë e njëjta gjë, siç ndodhi me TEC-in e Vlorës", - theksoi ai.

SHTËPITË E PUSHIMIT NË DIVJAKË, BURIM I VAZHDUESHËM ABUZIMI

Mungesa e transparencës për vendime të rëndësishme që prekin komunitetin duket se është një sëmundje e vjetër e pushtetit vendor dhe qendror në Shqipëri.

Sekretari i Këshillit Bashkiak të Divjakës, Rrapi Perriu, e kujton të freskët vitin 2010, kur ai dhe këshilltarë të tjerë kërkuan transparencë në procesin e dhënies me qira të 338 ambienteve të pushimit në plazhin e Divjakës.

Të trashëguara nga komunizmi dhe të vendosura në kabina njëkatëshe dhe ndërtesa me tri kate, ato i kaluan në pronësi Bashkisë së Divjakës në vitin 2006 me një vendim të Këshillit të Ministrave. Pak vite më vonë, kryetari i asaj kohe në Bashkinë e Divjakës, Irakli Gorreja, nisi procesin e dhënies me qira me argumentin e mirëmbajtjes së tyre dhe fitimeve që bashkia duhet të merrte nga këto prona.

"Në atë kohë nuk u kryen dëgjesa publike me banorët, nuk u mor mendimi i tyre për mënyrën sesi duhet të jepeshin me qira. Ne i kërkuam kryetarit dokumentacionin e dëgjësave me banorët, por nuk e morëm kurrë. Arritëm ta çonim çështjen edhe në prokurori, por aty u mbyll pa asnjë rezultat", - kujton Perriu.

Sot, banorët e zonës nuk duan të flasin publikisht për këtë proces të ndodhur tetë vite më parë, por nën zë ata theksojnë se ambientet e pushimit në Divjakë u morën me qira afatgjata dhe çmime tepër të ulëta nga njerëz të lidhur me pushtetin dhe ata që drejtonin sistemin e drejtësisë në vend.

"Njerëz me pushtet, mes të cilëve prokurorë dhe gjyqtarë, përfituan nga pronat e bashkisë në breg të detit. Ata përdorën emrat e familjarëve të tyre për t'i përvetësuar ato në mënyrë të fshehtë. Ban-



orët e Divjakës që përfituan nga qiradhënia numërohen vetëm me gishtat e njërës dorë", - theksoi një qytetar që nuk pranoi të identifikohet.

Por procedurat jotransparente të qiradhënies u bënë një e "keqe e vogël" krahasuar me atë që ndodhi në shtator të vitit 2013 - ditët e fundit të qeverisjes së Partisë Demokratike - kur Ministria e Ekonomisë përmes Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, inicioi procesin e shitjes së katër prej këtyre ndërtesave, ku gjenden gjithsej 48 hyrje.

Bashkia e Divjakës, pronare e ndërtesave që prej vitit 2006, u la tërësisht jashtë vendimmarrjes, e aq më pak, banorët e kësaj zone. Në raportin e monitorimit të KONCESCAN-it, ky veprim konsiderohet një abuzim i rëndë i pushtetit qendror, në shkelje të interesave të bashkisë. Nisur nga kjo, projekti vendosi në lëvizje Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili pas kontrolleve në terren dhe dokumentacionit, evidentoi problematikën dhe nxori rekomandime për zgjidhjen e situatës.

Por, sipas raportit të monitorimit, Bash-



kia e Divjakës ka neglizhuar duke mos e ndjekur deri tani çështjen në gjykatë.

"Ky organ administrativ duhet që të vendosë në vend të drejtën e shkelur ligjore,



duke iu drejtuar me padi gjykatës kompetente... për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratave të shitjes së kabinave", - theksohet në raportin e KONCESCAN-it.

DREJTËSIA SI SHPRESË E FUNDIT

Andi Bualli, jurist pranë Bashkisë së Divjakës, thekson se brenda pak ditësh ai do të dorëzojë në gjykatën e rrethit të Lushnjes pavlefshmërinë absolute të shitjes së shtëpive të pushimit.

"Ky rast përbën një shkelje të paprecedentë ligjore. Këto kontrata janë tërësisht abuzive dhe çështja tani zgjidhet në

gjykatë", - theksoi ai.

Ndërkaq, ankimi i vendimit për ngritjen e inceneratorit të Fierit në gjykatë duket se është hapi i radhës i aleancës së formuar mes banorëve të Vërrisë dhe organizatave joqeveritare për ruajtjen e mjedisit në vend.

Mbështetja e Lëviz Albania-s për AKIP, përmes projektit "Prapsim Inceneratorëve, portave të Importit të Plehrave - PIPPI", krijoi kohezionin e duhur për këtë hap dhe ndihmoi për të grumbulluar prova të mjaftueshme se koncesioni për ndërtimin e inceneratorit të Fierit ka kaluar përmes shkeljeve të shumta ligjore.

Lavdosh Ferruni theksoi se padia në Gjykatën Administrative, ku do të kërkohej pavlefshmëria e vendimit të Këshillit Komëbëtar të Territorit që i hapi dritën jeshile ndërtimit të inceneratorit në Vërrin, nuk do të vonojë.

Sipas tij, baza ligjore kundër këtij vendimi është e gjerë dhe nis që nga moszbatimi i ligjit për informimin e publikut; te mosrespektimi nga vetë qeveria, i strategjisë së menaxhimit të mbetjeve; mungesa e studimeve hidrogeologjike në zonë; për të përfunduar me faktin se koordinatat për ndërtimin e impiantit janë të ndryshme nga ato ku ai po ndërtohet realisht.

Banorët e Vërrisë e mbështesin këtë nismë dhe theksojnë se nuk do të kenë paqe, derisa ta shohin çështjen në gjykatë.

Landi Golemi tha se, pavarësisht lodhjes nga protestat e pandërprera për një vit e gjysmë, banorët nuk kanë ndërmend ta lënë kauzën në mes.

"Ne nuk duam të largohemi nga toka jonë. Do të bëjmë çdo përpjekje për jetuar këtu të sigurt dhe me dinjtet", - theksoi ai.

Agjencia e Trajtimit të Pronave çel procedurat për pranimin e aplikimeve, gjashtë dokumentet

ATP: 157 pronarët që marrin 167 milionë lekë

Përfituesit në Durrës, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave çel aplikimet për kompensimin e 157 pronarëve që u është zënë toka nga ndërtime pa leje. Përfituesit janë në qarkun Elbasan, Berat, Durrës, Tiranë, Korçë, Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë dhe qarkun Dibër. Masa e kompensimit financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet e legalizuara arrin në rreth 167 milionë lekë.

APLIKIMI

Agjencia e Trajtimit të Pronave çel në datën 18 qershor procesin për pranimin e kërkesave për kompen-

KERKESAT

Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 29.06.2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjitha subjektet e interesuara, të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën rruga "Muhamet Gjollështa", nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte.

simin e pronave që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. "Agjencia e Trajtimit të Pronave njofton fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.291, datë 21.05.2018, VKM. Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 29/06/2018 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar

dhe i kufizuar në kohë. ATP fton të gjithë subjektet e interesuara, të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën Rruga "Muhamet Gjollështa", Nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të premte, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatës", thuhet në njoftimin e Agjencisë. Sipas ATP-së subjekti kërkuar (subjekti përfitues/trashëgimtar i ligjor/përfaqësuesi me prokurë), në momentin e pletësimit të kërkesës për kompensim,

duhet të paraqesë: kërkesën për kompensimin e pronës, dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues prokurorin e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre, vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfitur; fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

GJASHTË DOKUMENTET

- 1.Kërkesën për kompensimin e pronës, sipas formatit tip, që i vihet në dispozicion nga ATP;
- 2.Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil;
- 3.Prokurorin e posaçme, të nënshkruar nga të gjithë subjektet që drejtojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre, paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën takuese në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjese të tyre, për çdo kërkesë të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dy mijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtes pasuri të paluajtshme);
- 4.Vërtetimin origjinal të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfitur;
- 5.Fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
- 6.Mandat pagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 lekë.

1200 PRONARËT QË MARRIN LEKË

LISTA E SUBJEKTEVE PËRFITUES NGA FONDI I ALUIZNI-T (Kësti i parë, i dytë, i tretë, i katërt dhe i pestë - në total 70% - grupi i gjashtëdhjetë)										
N.r. rendor	Nr. kërkesë	Datë kërkesë	Përfaqësuesi me prokurë			Qarku	Numri i zonës kadastrale	Numri i pasurisë		
			Emër	Atësi	Mbiemër					
1	877-A	02.09.2015	BARDHYL	NAIM	SHASHAJ	TIRANE	8140	6/258		
2	962-A	12.11.2015	AGRON	TEKI	TELA	ELBASAN	8527	160/1		
3	962-C	13.11.2015	SHEGUSHE	MASAR	KOSOVA	ELBASAN	8527	160/1		
4	962-D	13.11.2015	FELATUN	MAZLLEM	KARAIKKAJ	ELBASAN	8527	160/1		
5	962-B	13.11.2015	ANITA	MASAR	ALIÇKA	ELBASAN	8527	160/1		
6	969-A	23.11.2015	VIRTYT	LUTFI	SOKOLI	SHKODER	3072	412/2		
7	989-A	10.12.2015	ARIANA	RAMAZAN	PECANI	TIRANE	8310	5/115		
8	989-B	14.12.2015	BUJAR	OSMAN	DEMNERI	TIRANE	8310	5/115		
9	989-C	08.02.2016	FRENS	NIRVAN	DEMNERI	TIRANE	8310	5/115		
10	1068-A	09.05.2016	ERMIRA	MEHMET	ARIFI	TIRANE	3292	116/17		
11	1070-A	09.05.2016	ROBERT	GANI	XHEPA	TIRANE	3321	433/122		
12	1080-A	02.06.2016	FATMIR	BESIM	MURTHI	TIRANE	8340	5/63		
13	707-I	18.08.2016	NERMIN	PETRIT	ÇANGU	TIRANE	8140	2/364		
14	1080-B	18.08.2016	XHELAL	MALIQ	MURTHI	TIRANE	8340	5/63		
15	1080-C	24.08.2016	JEMINE	MEHMET	KORÇA	TIRANE	8340	5/63		
16	1191-A	01.09.2016	GEZIM	HYSEN	GRORI	TIRANE	8120	8/916		
17	1068-B	09.09.2016	ISMAIL	ISUF	QOSJA	TIRANE	3292	116/17		
18	1241-A	11.10.2016	EDILE	BESIM	TAKO	TIRANE	8180	2/129		
19	1243-A	13.10.2016	MAJLINDA	NEXHDET	VEIZI	VLORE	8604	3/100		
20	1243-B	14.10.2016	ALBA	FATOSH	BALLA	VLORE	8604	3/100		
21	1254-A	27.10.2016	LILA	SULEJMAN	KARAJ	ELBASAN	8526	2/188		
22	1243-C	25.11.2016	LAURETA	BARDHOSH	HIBROJ	VLORE	8604	3/100		
23	1306-B	17.01.2017	GEZIM	SIRI	JASA	TIRANE	8270	6/453		
24	1306-A	17.01.2017	YLLI	NAIM	JASA	TIRANE	8270	6/453		
25	1243-D	18.01.2017	ENKELA	HAMDI	BALLA	VLORE	8604	3/100		

26	1306-C	23.01.2017	BESNIK	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/453		
27	1306-D	23.01.2017	REZART	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/453		
28	1333-A	26.01.2017	BRIKENA	SEZAI	BAXHAKU	ELBASAN	8527	1376/26		
29	1339-A	30.01.2017	FATIME	RAMAZAN	TOLA	ELBASAN	8526	83/1/3		
30	1345-A	02.02.2017	LUMNIJE	ABDULLAH	GECA	TIRANE	8210	7/279		
31	1345-B	06.02.2017	BUKURIJE	ABDULLA	BOLLATI	TIRANE	8210	7/279		
32	1306-F	09.02.2017	ANILA	NIKOLLAQ	SHAMETI	TIRANE	8270	6/453		
33	1306-E	09.02.2017	MIMOZA	NIKOLLAQ	SHUTURIQI	TIRANE	8270	6/453		
34	1339-B	16.02.2017	LIRI	QAMIL	NEZHA	ELBASAN	8526	83/1/3		
35	1333-B	23.02.2017	IRENA	MEHMET	DARDHA	ELBASAN	8527	1376/26		
36	1334-B	23.02.2017	IRENA	MEHMET	DARDHA	ELBASAN	8527	1376/28		
37	1360-E	20.03.2017	BASHKIM	NAZMI	KOKALJARI	TIRANE	8120	9/565		
38	1345-C	21.03.2017	MIMOZA	HIQMET	NEZIRI	TIRANE	8210	7/279		
39	1345-D	26.04.2017	GIAKOMO	HIQMET	TJEGULLA	TIRANE	8210	7/279		
40	1243-E	27.04.2017	GELO	RAKIP	BALLA	VLORE	8604	3/100		
41	1080-D	03.05.2017	VJOLLCA	MALIQ	MUZHAQI	TIRANE	8340	5/63		
42	1434-A	09.05.2017	ELDA	ISUF	RABETA	ELBASAN	8526	314/1		
43	1436-A	11.05.2017	MIREL	KADRI	SHIMA	TIRANE	8230	5/730		
44	1434-B	15.05.2017	RUDINA	ADEM	DYLGJERI	ELBASAN	8526	314/1		
45	1445-A	17.05.2017	IBRAHIM	KASEM	SPAJA	TIRANE	3976	68/30		
46	1434-C	22.05.2017	KLEVIS	BUJAR	BAKALLI	ELBASAN	8526	314/1		
47	1434-D	05.06.2017	SAMI	FATMIR	SOJLI	ELBASAN	8526	314/1		
48	1080-E	20.06.2017	LIRI	MEHMET	LEKA	TIRANE	8340	5/63		
49	1485-A	21.06.2017	HAXHI	NEXHMI	RADAJ	TIRANE	8120	8/897		
50	1489-A	03.07.2017	BAJRAM	IBRAHIM	ONUZI	KUKES	2762	47/25		
51	989-D	19.07.2017	ESHREF	SALI	DEMNERI	TIRANE	8310	5/115		
52	1306-G	21.07.2017	ANILA	NIKOLLAQ	SHAMETI	TIRANE	8270	6/453		
53	1369-B	07.08.2017	EMINA	TOMOR	MACI	TIRANE	8180	5/248		
54	989-E	08.08.2017	ENGEJLLUSHE	ENVER	SOTOMENI	TIRANE	8310	5/115		
55	1362-H	13.09.2017	DALIP	KADRI	BAKALLI	ELBASAN	8527	1372/7		
56	1434-E	13.09.2017	DALIP	KADRI	BAKALLI	ELBASAN	8526	314/1		

(vizon)

Veliaj: Mundësi e mirë për të qëndruar larg veseve

Shkolla "Ahmet Gashi" në Laprakë hap dyert për të rinjtë e apasionuar pas sportit

Shkolla "Ahmet Gashi" në kryeqytet ka hapur dyert për të gjithë të rinjtë e zonës së Laprakës që dëshirojnë të zhvillojnë aktivitetet sportive gjatë orëve të pasdites. Kryebashkiaku Erion Veliaj, ditën e djeshme ka qenë i pranishëm në inaugurimin e kësaj shkolle ku ka theksuar se shfrytëzimi i ambienteve sportive, është një mundësi shumë e mirë për të rinjtë. "Sa bie zija e mësimi, shumica e këtyre terrereve boshatisen. Në një Tiranë me 1 milion banorë,

THIRRJA E KRYEBASHKIAKUT

"Sa më shumë prindër që i sjellin fëmijët të merren me sport, aq më pak fëmijë do të kemi nesër në pikat e basteve, nëpër kafene. Një mënyrë për të shmangur që kjo gjeneratë, të mos ketë fatin e gjeneratave të mëparshme, është t'i sjellim në kurse të tilla", - tha Veliaj.

me kaq shumë të rinj, a e kemi luksin që t'i lëmë të pashfrytëzuara? Mezi pres që tani që kemi hapur 62 palestra, të kemi, gjithashtu, edhe një kampionat mes 62 skuadrave rinore. Në

qoftë se i gjithë qyteti i Tiranës përfshihet nga kjo valë sportive, do të kemi një qytet shumë herë më të mirë nga ai që kemi sot", - tha Veliaj. Ky i fundit theksoi se investimet cilësore të

bashkisë janë një mundësi më shumë që nga shkollat e kryeqytetit të dalin talente të reja në të ardhmen. "Ndoshta nga e gjithë Laprakë do spikasin 5-6 talente, por 60 të tjerët, do mësojnë si të jenë qytetarë më të mirë të Tiranës. Për një kryetar bashkie, interesi më i madh është të këta të fundit, jo të sporti elitare, sepse pyetja është: A kemi qytetarë elitare? E kemi në dorë vetë", - u shpreh kryebashkiaku. Më tej, ai u bëri thirrje të gjithë prindërve që të regjistrojnë fëmijët e tyre



Kryebashkiaku Erion Veliaj dhe në shkollën "Ahmet Gashi"

në një nga kurset sportive, në mënyrë që ata të qëndrojnë larg veseve dhe jetës sedentare. "Sa më shumë prindër që i sjellin fëmijët të merren me sport, aq më pak fëmijë do të kemi nesër në pikat e basteve, nëpër kafene. Një mënyrë për të shmangur që kjo gjeneratë, të mos

ketë fatin e gjeneratave të mëparshme, është t'i sjellim në kurse të tilla", -tha Veliaj. Kryebashkiaku nuk harroi të shprehte vlerësimin e tij edhe për stafin e mësuesve dhe të trajnerëve që po përhapin një kulturë të re në kryeqytet, duke sjellë masivizimin e sportit tek të rinjtë.

Reagon Ministria e Arsimit: Po punojmë për një zgjidhje, mos u shqetësoni për pagat

Ulje pagash për 4 mijë infermierë, Jaçaj: Do i drejtohem gjykatës

"Drejtnesit e fakultetit janë përgjegjës për situatën"

Voltiza Duro

Rreth 4 mijë infermierë që kanë zhvilluar studimet në vitet 2002-2006 në Universitetin e Mjekësisë, u njoftuan në mars të këtij viti se diploma e tyre do të njihet si Bachelor dhe kjo do të ndikonte, gjithashtu, në uljen e pagës me 50 mijë lekë të vjetra. Përveç kësaj, infermierëve do t'u duhej të kthenin mbrapsht çdo pagësë të marrë nga viti 2015. I pyetur nga 'Gazeta Shqiptare', kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj tregon se zanafilla e këtij problemi ka nisur që në vitin 2015-të, nëpërmjet një vendimi që parashikonte mosnjohjen e diplomave të sistemit të Gjenevës si master shkencor. "Në 2015 është nxjerrë ky vendim që diplomat e sistemit 3.5 vjet, sistemi i Gjenevës të mos konsiderohet më e ekuivalentuar si master shkencor dhe çuditërisht kujtohen ta zbatohet pas 3 vitesh. Nëpër rrethe ka filluar në shtator ndërsa në Tiranë, pra në QSUT ka filluar në mars ku infermierët janë njoftuar vetëm me një shkrësë nga institucioni ku punojnë që diploma e tyre do njihet si bachelor dhe do kenë ulje page", - thekson Jaçaj për 'GSH'. Më tej, ky i fundit bën me dije se përveç kësaj do t'u duhet të kthejnë mbrapsht çdo pagësë të marrë që nga 2015, pra çdo infermieri do i ulet paga me rreth 50 mijë lekë të vjetra ku përfshihet ulja e pagës dhe kthimi mbrapsht i parave shtesë të marra në këtë periudhë. "Pra, dhe nëse ata duan të kenë të njëjtin pagë duhet të bëjnë master shkencor. Cudia është që pse një vendim i miratuar në 2015, kujtohen ta vënë në zbatim sot



PETICIONI

"Ne po mbledhim firmat për peticion, të cilat do i dërgohen çdo institucioni deri në zgjidhje, në të kundërt çështja do shkojë në gjykatë. E gjitha është shkaktuar nga drejtnesit e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë", - theksoi Jaçaj.

dhe jo njëkohësisht në çdo institucion, pasi dhe në QSUT nuk është se janë prekur të gjithë pasi po verifikohen", bëri me dije kreu i Shoqatës së Infermierëve. Aktualisht, kjo shoqatë po mbledh firmat për një peticion që parashikohet t'i dërgohet çdo institucioni përgjegjës deri në zgjidhjen përfundimtar të problemit. "Unë si përfaqësues i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë kam dhënë disa deklaratat në lidhje me këtë çështje. Ne po mbledhim firmat për peticion, të cilat do

i dërgohen çdo institucioni deri në zgjidhje, në të kundërt çështja do shkojë në gjykatë. Është një ligj që ka vijë prapavepruese dhe që nuk po zbatohet në mënyrë të drejtë, por e



Kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj

gjitha është shkaktuar nga drejtnesit e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë", - theksoi Jaçaj. Ky i fundit u shpreh për 'Gazeta Shqiptare' se e gjithë kjo ka ardhur pasi dekanati ndihet i kërcënuar nga rritja profesionale e infermierëve e madje prej një viti u ka bllokuar dhe doktoraturat pasi mendon që kështu të rinjtë mund të marrin dhe drejtimin e fakultetit.

REAGIMI I MASR

Pas debateve të shumta e reagimeve nga Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë, Ministria e Arsimit, në një deklaratë për media ka bërë me dije se po ndjek çështjen me përparësi. "Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë po ndjek me përparësi çështjen e njohjes së diplomave të infermierëve që kanë përfunduar studimet në vitin akademik 2002-2006. Së bashku me Universitetin e Mjekë-

4

MIJË INFERMIERË

Rreth 4 mijë infermierë që kanë zhvilluar studimet në vitet 2002-2006 në Universitetin e Mjekësisë, u njoftuan në mars të këtij viti se diploma e tyre do të njihet si Bachelor dhe kjo do të ndikonte, gjithashtu, në uljen e pagës me 50 mijë lekë të vjetër.

sisë jemi në diskutime për t'i dhënë një zgjidhje definitive kësaj çështje sensitive për rreth 4 mijë infermierë", - theksohet në njoftim. Në këtë të fundit thuhet se infermierët nuk duhet të kenë asnjë shqetësim lidhur me pagat pasi situata po zgjidhet ligjërisht në favor të infermierëve.

ZYRA PËRMBARIMORE PRIVATE ENIRJETA ZISI

Permbareues private Enirjeta Zisi zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Apartamenti" me sipërfaqe 92.1m2, ZK.3866, Nr.Pasurie.300/143+1-7, Vol.83,Fq.186,Indeksi i Hartes K-34-100, te ndodhur ne Tirane, Yzberisht prane rruges "Joklin Pensi", kati i 3, shk.1, ap.7 Tirane,per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditort Yzeir Llanaj.

Cmimi i ri me te cilin shpallet ankandi është ne shumen 3.010.392 (tre mijlon e dhjete mijë e treqind e nentdhjete e dy) lekë.

Ankandi zhvillohet ne date 04.07.2018, ora 16.00 ne zyrën e Permbareueses gjyqesore private Enirjeta Zisi,Bulevardi "Gjergj Fishta", Pallati "Gora"Kulla.2,Kati i 2, Tirane Nr.Tel. 0694799000, email:enirjeta.zisi@gmail.com

Permbareuesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankad pasurine :

a) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 52011 , volumi 10 , Fraq 248, ne zonen kadastrale nr 1100 , me sipërfaqe totale 3230 m2 , e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder b) Tokë are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 52321 , volumi 9 , Fraq 3, ne zonen kadastrale nr 1100 , me sipërfaqe totale 2360 m2 , e ndodhur ne adresen Barbullush Shkoder

2. Cmimi me te cilin do te filloje shitja ne Ankand për pasurinë e sipërpërmënuar, është ne vleren "Për pasuritë "Toka Are" me sip 3230 m2 , është ne vleren 488.376 leke

Për pasurinë "Toka Are" me sip 2360 m2 , është ne vleren 356.632 leke Shitja e pasurisë filton me date 04.07.2018 ora 16.16 ne Zyrën e permbareuesit gjyqesore Genti Bushati me adresse Rruga Don Bosko , Perballë Gjyqesës se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdheni perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051,

DEBATI PER TEATRIN

Teatri, nderi i humbur i elitave dhe rastet e kinemasë "Zvezda" e "Termokiss"

Fatmira Nikolli

Edhe njëherë, ia dolëm mbanë të shkatërrojmë atë që nuk mundëm ta ndërtonim". Kjo frazë e Stephen King në "Green Mile" duket sikur është shkruar për të përshkruar atë që po ndodh me Teatrin Kombëtar dhe raportin që ka ndërtuar me objektin mazhoranca. Në një qytet ku çdo projekt i shitur si dashuri për të bukurën ka prodhuar kaos urban dhe ka rrafshuar kujtesën e kulturën, pakkush ka besim të konceptit push-tetar për të bukurën e për të vërtetën. Dhe e vërteta është edhe një kasolle, që refuzon të shembet për t'ia lënë vendin një fasade qelqi. Më shumë se sa të përmirojmë të ardhmen e qytetit, energjitë dhe ditët shkojnë duke luftuar për të ruajtur ato pak vlera që kemi.

E bukura, nuk mund të ndërtohet mbi projekte që nuk ishin, që fillojnë të shihen nga sirtarët e bashkisë, që mandej u bëhet prezantim pompoz në kryeministri me premtim se zgërdallës do ia zërë vendin godina e qelqitë e që 2 javë më pas mohohet të ishte projekt, por vetëm një propozim. Vetëm për mjegullën me të cilën çështja u mbështoll meriton gjithë protestën. Hija efillimit, u pasua nga protestat e çdo të hëne, derisa një projektligji, i nxori artistët të bashkuar në protesta të përditshme: për teatrin, për truallin, për publikun, për ligjin, kundër arrogancës e pushtetit, kundër PPP, kundër tjetërimeve, për teatër pa kulla para, pa kulla pas, pa kulla në të majtë e pa kulla në të djathtë. Kjo, ishte shfaqja më e bukur që aktorët dhanë dhe nuk ishte në teatër- ishte para teatrit. Besova, besova deri në fund që po luanin vetveten dhe jo një tekst të çfarëdoshëm, të shkruar diku, dikur për një mbret autoritar. Në mes të marsit, një prej aktorëve që tanimë është tërhequr me turp, më fliste për kinematë e kahershme që u shembën me premtimin e zëvendësimit me salla moderne. Hiçgjë nuk mbet prej tyre veç fotove ngjitur mureve të arkivave. Më thoshte se artistët dhe në daçin të besojnë, u mungojnë shembujt. Tanimë, pyes veten se si ky artist mundi të besojë dhe se si u dorëzua. A thua, në këta muaj vetëm sa luajti vetëm një prej roleve të jetës së tij në një skenë krejt të re? A është kjo elita që kemi? A është ky, nderi ynë i humbur? "Je si dashi, vëllai im.



Kur xhelati i veshur me lëkurën tënde, Ngre shkopin lart, Ti ngutsh të futesh prapë në tuftë Dhe shkon duke vrapuar në thetore, gati krenar. Dhe nëse ka shumë mjerim mbi tokë Kjo ndodh falë teje, vëllai im. Nëse jemi të uritur, të rraskapitur, Nëse jemi të rrjepur deri në gjak, Të shtypur si rrushi për të nxjerrë verën tonë, Mezi arrij ta them Por faji është i yti vëllai im" (Nazim Hikmet)

Pas kinemave publike, për të mos i lënë vend imagjinatës po përsërisim vetveten deri në çmenduri, duke shembur çdo gjë që diç ruan prej një Tirane që dikur që ndërtuar me plan urbanistik, të një Tirane që ka memorien e vet, duke e kthyer atë në një qytet që ha vetveten, për të prodhuar një rrokopujë ku në një shtet ligjor, në një shtet të së drejtës nuk mund të ishte menduar as në ëndrrat më të frikshme. Jemi në një shtet, ku nuk paska më asnjë institucion që mundet të mbrojë a të kundërshtojë një qeveri, a t'i kërkojë llogari; jemi në një shtet ku gjykata luan vetëm 'rolin' si çdo aktor teatri. Propaganda e tejskajshme qeveritare, jo vetëm që nuk bind, por veçse të kujton kohët e monizmit, kur para se t'i vinin kazmën kishave e xhamive, morën tonelata letrash me kërkesa nga populli e brenda e jashtë vendit- gjer edhe nga studentët shqiptarë në Lindje. Të gjithë kërkimin t'u mbylleshin dyert e institucioneve fetare që paskëshin genë opim për popullin. Në pesë vitet e qeverisjes së majtë, Ministria e Kulturës ka mundur të "rriindë" disa institucione: nga restaurimi i Migjenit, te muzeu Marubi, nga Muzeu i Ikonave në Korçë te ai i Gjethit në Tiranë, qeveria e ka

dhënë një shembull se e di si bëhen rilindjet e institucioneve. Si për të treguar anën tjetër të saj, e zezë e për çudi e ndritshme, ligjëron si suksese përkrah atyre që u përmendën edhe "Qemal Stafën". Rrënim i trashëgimisë në emër të modernizmit po shitet si politikë kulturore. Me ndërhyrjet në kalanë e Tiranës, me shembjen e Teatrit Kombëtar dhe tjetërimit të truallit të tij e pranë tij, të lëna në zgrrip të mbijetesës, si teatri janë edhe Galeria Kombëtare e Muzeu Kombëtar, "mos paçin fatin e Marigosë".

ZVEZDA E TERMOKOS

Kur shumica e aktorëve janë dorëzuar në forma të ndryshme, dikush prej indiferentizmit, dikush se është rrogëtar i shtetit, dikush se e blenë e dikush se e gënjen, pak shpresë ka mbetur: Vetëm aktet e çmendurisë mund ta

shpëtojnë teatrin dhe me teatrin tanimë nuk kuptohet vetëm teatri- kuptohet çdo pronë e institucion publik që përfaqëson shumë për memorien tonë. Kuptohet t'i bësh pritë së ardhmes për Muzeun e Galerinë, kuptohet t'i vësh kufi vendimeve piramidë. Urgjenca e hartimit, kalimit e miratimit të një projektligji, thotë se nuk ka më kohë për të humbur. Në mundshin, pra artistët e mbetur të bëjnë një akt çmendurie për ta shpëtuar atë tokë dhe nderin e humbur të intelektualit shqiptar, diç do kemi fituar.

Mjaft të marrin shembullin në Kosovë ose në Serbi. Mjaft të shohin çfarë ka ndodhur me "Termokiss"-in në Kosovë, kur një grup të rinjsh e pushtuan dhe e kthyen në skenë arti. Ajo ishte një ndërtesë betoni e papërfunduar që është ngritur në vitin 1997 nga Termokiss (kompania e ngro-

RAMA

Kryeministri Edi Rama përmes një postimi në 'Facebook' ka shkruar se salla e re e teatrit "Turbina" do të hapet më 2 korrik. "Të hënën 2 korrik në mbrëmje hapet në Tiranë SKENA e RE #arTurbina. Një tjetër investim i qeverisë shqiptare për artistët dhe dashamirët e teatrit, baletit, muzikës e arteve pamore".

hjes në Prishtinë) dhe që menduar të ishte baza e fabrikës së ngrohjes qendrore në qytet. E lënë në mëshirë të fatit, të rin-

jtë e zaptuan dhe nuk pranuan ta lëshonin derisa e kthyen në qendër arti- sot ndër më të mirat. Kinema "Zvezda" në Beograd ishte një prej kinemave më popullore në qytet, deri më 2007 kur pas një privatizimi ra në duart e një biznesmeni lokal që kishte si qëllim shkatërrimin e saj. E shpëtuan duke e zaptuar- qëndruan 40 ditë brenda derisa morën të drejtën të kishin. Të rinjtë e Kosovës dhe ata të Beogradit i "pushtuan" institucionet që donin. Asgjë nuk është e lehtë, kush tha se do të ishte? Lufta nuk fitohet në tavolinë, në tavolinë bëhen pazare.

SHKURT

Robert Ndrenika: Ju lutem mos më kryqëzoni, nuk jam Krishti as Baraba

Pas një sërë debatesh për çështjen e teatrit dhe pasi mes të tjerësh edhe Robert Ndrenika ra dakord për teatër me PPP, vetë aktori ka reaguar.

Ja postimi i plotë i tij:

Ju lutem... mos më kryqëzoni! Për dijeni mikeshës sime, gazetares Fatmira Nikolli, por le ta dijë dhe 'tan bota mbarë!' Kam qenë (prej vitesh) dhe jam për një Teatër Kombëtar të ri dhe bashkëkohor, të cilin e ka për DETYRË ta bëjë shteti shqiptar (paratë le t'i marrë ku të dojë, ndoshta dhe atje ku i merrte Josif Broz Tito)! Këtë gjë nuk e kam mbajtur të fshehtë, por ua kam bërë të ditur prej kohësh kolegëve të mi, por kur ka qenë publik dhe në shqiptarist. I vetmi lëshim që kam bërë ditët e fundit është se kam pranuar PPP me kushtin e vetëm që përveç godinës (teatër) që do të ndërtohet në favor të PPP nuk do lëshohet asnjë cm katror nga TOKA e TEATRIT KOMBËTAR! Të kanë gënjyer do të thotë dikush dhe unë përgjigjem po BESA e shqiptarit ku vete? Së fundi, ju bëj të ditur se nuk jam JEZU KRISHTI bile as BARABA dhe gojënj nuk e kam vetëm për të ngritë kos (pa yndyrë) dhe të pi ilaçe, por e kam edhe për të FOLUR! Me respektë të ndërsjella, Robert Ndrenika.

ADI KRASTA PËR TEATRIN: E TURPISHME SHEMBJA E ARROGANCA



fat (nëse çmendin krejt) do ketë shumë shpejt Muzeu Kombëtar e Galeria Kombëtare.

përvuajtjen e mungesës së një teatri. Teatri mund të ndërtohet i bukur e modern kudo tjetër ku nuk dëmtohet trashëgimia, kujtesa e sensibiliteti, goftë edhe i një pakice. Shumica që vendos me votë politike është veshspallur sot si asnjëherë edhe si njohëse e arkitekturës edhe si njohëse e urbanistikes edhe si njohëse e aktrimit (sidomos aktrimit) dhe me arrogancën e padijes vulos dhe çfarë është vlerë e çfarë jo për këtë vend. 2. Paligjshmëria apo shembja e paturpshme e çdo ligji që lejon një tjetër SHEMBJE. Atë të Trashëgimisë. Nuk është hera e parë. Këtë fat pati stadiumi "Qemal Stafën" e këtë

kerë betoni si muze në mes të Tiranës, mund të shndërojnë në muze një teatër kombëtar - trashëgimi kulturore, në emër të frymëve që e mbajtën gjallë. Një qeverie të (pa)përgjegjshme dikush mund t'i kujtojë se Londra është e mbushur me ndërtesa teatroshe të vjetër që ndoshta nuk hynë as në listën e trashëgimisë së ligjëruar e që ju bien çathtë në mes të shfaqjeve e përsëri nuk shemben në emër të rrëmbimit të territorit. Teatrot e rinj janë ndërtuar modestë me përkushtim të sinqertë politikash kulturore e me donacione dashamirësish. Jo poshtë kullave e jo brenda tyre.

3. Propaganda e neveritshme që po mpin reagimin edhe kur të mbytet me makinërinë e "fake news" rilindas-gjoja-leftist edhe kur të shan nga nëna e nga "robtë". Një qeveri që ngriti bun-



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 616

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 30 Qershor 2018



MODELJA HANA NOKA, VJEN SI REGJISORE,
FILMI I NOMINUAR PER 3 ÇMIME NË SHBA

"BARBIE DHE KEN"

Dasma madhështore e Afërdita Dreshajt me Jakub Kindl



Asnjë i ftuar VIP nga Shqipëria? Ja cilët ishin disa nga të pranishmit në Majemi. Ceremonia në breg të detit në Majemi dhe hoteli luksoz, detajet nga dita e shënuar e këngëtares



Muzikë e mirë dhe emocione të papërsëritshme

AYO
Elektrizon
publikun në
Amfiteatrin e Tiranës



KLODIANA SHALA:

Ju rrëfej pengun më të madh të jetës sime. Në 15 vjet kam bërë vetëm 5 ditë plazh

Flet ish-vrapuesja olimpike: Prindërit nuk më kanë përkrahur

KLODIANA SHALA:

Ju rrëfej pengun më të madh të jetës sime
“Në 15 vjet kam bërë vetëm 5 ditë plazh”

Edhe pse tashmë nuk është më pjesë aktive e sportit, vrapimit, ajo mbetet padyshim një nga një nga figurat që na ka bërë krenarë në përfaqësimin e vendit në Lojërat Olimpike. Klodiana Shala është atletja që ka thyer më shumë rekorde kombëtare dhe ka fituar më shumë medalje. Ajo është kampione shqiptare dhe rekordmenia absolute në 50, 100, 200, 400 metrave, dhe 110 metrave. Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Klodiana na rrëfen jetën e saj pas kësaj shkëputjeje tashmë prej disa vitesh nga garat e vrapimit duke iu përkushtuar palestrës së saj si dhe hobeve të tjera, të cilat prej vitesh i kishte lënë mënjanë. Ajo, gjithashtu, na ka zbuluar një nga pengjet më të mëdha të jetës së saj të cilën nuk ka arritur ta realizojë. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Elsa Doda

Klodiana ke disa vite që ke hequr dorë nga sporti, atletika me çfarë po merresh aktualisht?

Normalisht si çdo sportiste në botë, edhe për mua erdhi

momenti të mbyll karrierën time protagoniste, por kjo nuk do të thotë që unë jam larg sportit. Që prej shkëputjes nga sporti unë kam hapur një qendër fitnesi timen “Kinetic Fitness Powered By Klodiana



Shala” ku jam e angazhuar maksimalisht tani në shërbim të komunitetit me programe të mirëorganizuar dhe edukimin e aktivitetit fizik.

Çfarë të ka munguar më shumë nga përditshmëria e një atleti?

Të qenit atlete në nivel protagonist të lartë për një periudhë të gjatë, siç ishte e imja kërkon një impenjim të jashtëzakonshëm, impenjim të cilin, në fakt, njerëzit e zakonshëm, kur i tregojnë, iu duken si të pamundura. Tani është një impenjim tjetër dhe sigurisht ke edhe me shumë kohë të merresh me veten. Gjithsesi,

emocionin e garës, përqendrimin dhe ngarkesën emocionale dhe fizike përpara shkrepjes së pistoletës, përpara nisjes, është një ndjesi të cilën nuk mund ta gesh në asnjë moment tjetër. Ai është një moment unik.

Nëse nuk do të ishe sportiste çfarë do ishe? Në fëmijëri çfarë ëndëroje?

Këtë nuk di ta them pasi e kam filluar sportin në moshë të vogël dhe gjithë jetën time e kam pasur të lidhur me të, gjithsesi një pasion i pazëvendësueshëm për mua mbetet gatimi. Në fakt, unë hyj tek



Sa të ka mbështetur familja gjatë karrierës tënde, e ke ndërjet mungesën e tyre duke marrë parasysh faktin që ke jetuar vetëm në një moshë fare të re?

ËPër hir të së vërtetës, në fillim nuk kanë qenë shumë dakord, por më pas duke parë si rezultatet, por edhe dëshirën time të madhe për të vazhduar, kam pasur përkrahjen e tyre gjatë gjithë kohës. Për sa i përket mallit, normalisht që po, megjithatë unë kam qenë me fat pasi kur unë shkova të stërvitesha në Greqi edhe prindërit e mi erdhën atje. (Athinë) Kështu që kisha mundësi t'i takoja shpesh.

Çfarë ka ndryshuar në jetën tënde tani që nuk

tjera. Kam më shumë kohë për veten, ndoshta pak më shumë përgjegjësi për të tjerët. Përpiqem që gjatë gjithë kohës të jem e kujdesshme dhe korrekte. Edhe pse duhet të them përsëri se disiplina që kam pasur gjatë periudhës kur isha atlete profesioniste më ka ndihmuar shumë në këtë aspekt.

Ç'mund të na thuash për problemet që kanë ngritur shumë herë sportistët për kushtet në të cilat ata stërviten?

Kjo është një temë shumë e dhimbshme dhe e turpshme. Nuk ka asnjë justifikim mënyra se si qeveritë ndër vite kanë trajtuar sportistët. Unë kam qenë nga ato persona që si kur kam qenë

jetime dhe të lënë në harresë. Stërviten në kushte mizerabël me vetëfinancim dhe me një suport që është gati i barabartë me zero nga institucionet përkatëse.

Sa të zhvilluar e kanë shqiptarët kulturën e sportit sipas teje? Palëstrën tënde e frekuentojnë më shumë të rinj, të cilët duan një trup të bukur për muajt e verës?

ËJemi në nivele të frikshme të sëmundjeve të ndryshme, të cilat lidhen përgjithësisht me aktivitetin dhe përsëri askush nuk denjon të bëjë diçka në nivel institucional. Deviacionet e shtyllës kurri-zore janë kthyer në një normalitet: yndyrat, diabeti apo problemet me zemrën. Kjo është dramë. Në fakt jo, përgjithësisht ne kemi një anëtarësi të stabilizuar. Rreth 80% e kësaj anëtarësie e konsideron aktivitetin pjesë të rutinës së tyre ditore dhe ne jemi shumë të lumtur që jemi pjesë e zhvillimit të tyre. Atmosfera që mbizotëron është e jashtëzakonshme dhe jemi kthyer në një familje të madhe ku herë pas here organizohemi edhe me grupe ynë aktivite të ndryshme.

Gjithashtu, je përfshirë edhe në politikë, si e sheh si eksperiencë? Do të të shohim përsëri aktive?

Eksperiencë interesante dhe e rëndësishme, në fakt. ËPolitika është ajo e cila vendos se si duhet të funksionojnë gjërat dhe, në qoftë se dëshiron të kontribuosh për vendin apo për një sektor të caktuar, ke më shumë mundësi që t'i bësh gjërat e mundura. Sigurisht që ka presion, ka bërërylla, ka shumë

ata persona që nuk shikoj ëndrra, (qesh), bëj shaka. Ëndrra ime ka qenë Lojërat Olimpikë të cilën e realizova, në fakt, abuzova pak, duhet të them, pasi mora pjesë në 4 - Lojëra Olimpikë. Megjithatë një peng i madh i imi, pra një ëndërr e porealizuar ishte arrija në finale, pasi e kisha këtë rezultat në aktivitetet e tjera, por fati nuk ishte me mua.

Cilat janë disa gjëra që përfshirja totalisht në sport t'i ka privuar jetë?



merresh më me sport?


Ndryshojnë prioritetet. Në atë kohë qëllimi ishte një dhe i vetëm, rritja e nivelit sportiv dhe përmirësimi në maksimum i rezultateve dhe arrijtjeve në nivel kombëtar. Por më së shumti atë ndërkom-bëtarë, kurse tani janë të

Ou, pse ma bëre këtë pyetje?! Siç e thashë më parë, impenjimi në këto nivele është maksimal p.sh. maksimumi në orën 9.00 ne ishim në gjumë, pra jeta e natës e

ku di unë se çfarë ishin të pa konceptuara për ne. Edhe një detaj tjetër për ta kuptuar, në 15 vjet unë mbaj mend të kem bërë gjithsej vetëm 5 ditë plazh dhe kaq.

sportiste si tani i kam ngritur dhe do vazhdoj t'i ngre këto problematika. ËTë kalojnë kaq vjet dhe të mos ketë strategji për sportin është skandaloze. Sportistët tanë ndihen

gjëra, por në qoftë se di të imponohesh dhe të ruash integritetin, është një fushë ku mund të japësh shumë për vendin. Për sa i përket të ardhmes, mbetet për t'u parë.




Ceremonia në breg të detit në Majemi dhe hoteli luksoz, detajet nga dita e shënuar e këngëtares

"Barbie dhe Ken" më në fund martohen, dasma madhështore e Afërdita Dreshajt me Jakub Kindl

Pamela Aliaj

Prej kohësh e presim me padurim dasmën e këngëtares bukuroshe nga Kosova, Afërdita Dreshaj me hokestin çek, Jakub Kindl Scoresa. Që prej momentit që i dashuri i saj i propozoi në tarracën e një prej hoteleve më të njohur në Pragë të Çekisë, këngëtarja nuk ka rreshtur të shfaqë qdo moment romantik të kaluar në krah të të dashurit të saj të zemrës. Ajo ka marrë propozimin për martesë, që do ta kishin zili shumë vajza. Tamam si në filma, këngëtarja dhe modelja Afërdita Dreshaj mori pyetjen më të rëndësishme të jetës nga njeriu që dashuron, nën dritën e yjeve, rrethuar nga qirinj dhe trëndafila, në tarracën e një hoteli luksoz, në një prej qyteteve më të bukura të botës, Pragë. Që nga mbrëmja e funddhjetorit e deri më sot kur Afërdita lidhi jetën nën betimin e qirinjve së bashku me dashurinë e saj, Jakubin, kanë kaluar pothuajse 7 muaj. Një ceremoni madhështore, e veshur e gjitha me të bardha e zhvilluar pranë detit të Majemit në një nga hotelet më luksoze të këtij vendi, shënon momentet më të veçanta të çiftit Kindl Scoresa. Sipas burimeve për "Blue-


Asnjë i ftuar VIP nga Shqipëria? Ja cilët ishin disa nga të pranishmit në Majemi




tooth" të "Gazeta Shqiptare" prezent nuk kishte asnjë të ftuar VIP shqiptar, përveçse mikut të zemrës së Afërditës, Eraldo Rexhos. Përveç tij në praninë e saj, e quajtur edhe shoqëruesja e nderit, ishte modelja bukuroshe Xhesika Berberi. Ndërkohë që të ftuar

të tjerë të njohur ishin edhe modelja kosovare Vildane Zeneli, Tika Camaj si dhe ata që do ta përgatisnin nusen të ardhur posaçërisht për të nga Kosova si makeupartist Vjosa Camaj dhe fotografi e filmografi i njohur në Nju Jork, fitues edhe i 3 çmimeve

'Emmy', malazezi Amir Sukalic. Ndërkohë që ceremonia nisi në orën nëntë të ditës së premte në Majemi, (ku në Shqipëri shënonte 3 e mëngjesit), atmosfera ishte tashmë e parapërgatitur në hotel me të gjithë detajet e veçanta të veshura në të bardhë. Ndërkohë që nusja nuk harroi të postonte edhe në "Instastory" edhe menunë e ditës së dasmës. Ajo do të ishte mjaftueshëm e pasur, e përbërë nga katër pjesë, të cilat vetëm duke i parë të bëjnë të të lëshojë goja lëng. Pjatat ishin të përbëra kryesisht me bazë deti dhe stil meksikan, duke përfunduar me qershinë mbi tortë: çokollatën. Me siguri që të ftuarit do të kenë shijuar jo vetëm atmosferën dhe bukurinë e ceremonisë së dasmës, por edhe ushqimet fantastike të servurura në një nga hotelet më luksoze të Majemit, "1 Hotel South Beach". Kukulla Barbie, Afërdita Dreshaj, lidhi mbrëmjen e të premtës në Majemi të SHBA-ve jetën së bashku me çekun Jakub Kindl. Dhe ajo ishte padyshim një nga ceremonitë më të veçanta dhe më të bukura të VIP-ave shqiptarë që do të mbahet mend gjatë, e cila edhe hapi siparin e dasmave për këtë verë të 2018-ës.





Nisën pushimet ekzotike, Marina Vjollca shfaqet si latine nga Sardenia e Italisë

Këtëj ende bie shi, por kjo nuk i pengon VIP-at tanë të largohen për të shijuar rrezet e diellit aty ku vera ndihet vërtetë. Këtë gjë ka bërë edhe bukuroshja Marina Vjollca. Pak pushime ekzotike i ka të nevojshme, pse jo në një nga rivierat mesdhetare më të lakmuara të Italisë, në Sardenia. E shfaqur me një fustan shumëngjyrësh, duke kërcyer, moderatorja bukuroshe shfaqet si një latine e vërtetë.

Jo vetëm destinacione në plazh, ja ku po i kalon pushimet këngëtarja

Kush tha se deti është destinacioni i vetëm për të shijuar ditët e nxehta të verës? Ja që destinacionet nuk janë vetëm ato ekzotike dhe këtë na i tregon shumë mirë këngëtarja e njohur, Jonida Maliqi. Ajo ka zgjedhur të shkojë në Paris të Francës duke shijuar momente të veçanta në shoqërinë e shoqeve të saj. Nëpërmjet disa fotove në 'Instastory' ajo na sjell pak atmosferë parisiene. Kështu që mendoheni edhe një herë për ku do t'i keni destinacionet për këtë verë.



"Bëj mirë që të të marrin për budalla", me këtë është zhgënjyer moderatorja?

Zakonisht jemi mësuar me një shprehje të njohur shqiptare për të shërbyer njerëzve në nevojë, por mesa duket nuk është kështu për të gjithë. Nëpërmjet një statusi në 'Instagram', moderatorja e njohur, Fjori Dardha ka habitur me fjalët që ka postuar. "Bëj mirë që të të marrin për budalla", kjo është shprehja që ka hedhur moderatorja në 'Instastory'. Pra, jo më "Bëj mirë që të gesh mirë", mesa duket Fjori është zhgënjyer nga njerëzit, të cilëve u ka bërë nder. Kushedi pse është nxitur të bëjë një postim të tillë moderatorja e "Boom".

Temperaturat e ulëta? I ngre Kejvina për të gjithë!

E dhe pse ditë me shi nuk mungojnë fotot provokuese të VIP-ave tanë. E veshur me bikini dhe e shtrirë në pishinë Kejvina Kthella i ndezi të gjithë ndjekësit e saj në 'Instagram'. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe me velinën e "Xing me Ermalin", e cila nuk ngurron të shfaqë format e saj bombastike. Një foto ku ajo shfaqet me kurriz me bikini ku vihen në pah shumë mirë vithet e saj, padyshim që i bën të gjithë me zemër. E pse mos ta bëjë një gjë të tillë një velinë seksi si Kejvina?



U fejuan! Festa surprizë, trëndafila dhe propozimi romantik që reperi Gjiko i bën Elita Rudit për ditëlindje

Video dhe foto pafund! Mesa duket festa surprizë e moderatores kosovare, Elita Rudi ka përfunduar me një surprizë akoma edhe më të madhe. I dashuri i saj, reperi Gjiko, i ka propozuar në zemër të mbrëmjes për martesë. Pikërisht në ditën e saj të 25-vjetorit të lindjes, reperi zgjodhi t'i bënte surprizën e veçantë bukuroshes, e cila do të shënjojte edhe jetën e dy të rinjve. Trëndafila, foto dhe unaza me diamant ishin kryefjala e një mbrëmjeje të paharrueshme për bukuroshen, e cila tashmë do të nisë përgatitjet për një ditë akoma edhe më të madhe, për dasmën e saj!



Muzikë e mirë dhe emocione të papërsëritshme, Ayo elektrizon publikun në Amfiteatrin e Tiranës

Të gjithë për të shijuar tingujt reggae dhe soul, ja cilët ishin VIP-at e pranishëm në koncert

Pamela Aliaj


Para tri ditësh, këngëtarja me famë botërore mbërriti në Tiranë, ndërsa mbrëmjen e së enjtes ajo me notat e para rrëmbeu menjëherë zemrën e publikut kryeqytetas. Për këngëtare me famë botërore u paracaktua të këndonte në një skenë të thjeshtë në "Amfiteatrin" e Liqenit Artificial. Falë zërit të saj unik, Ayo arriti të gjente dëshirat dhe kënaqësinë e gjithë audiencës së pranishme me këngët e saj të bëra hit në gjithë botën. Për më tepër që modestia e saj si artiste dhe zëri i veçantë i ka mahnitur të gjithë. Gjithashtu, Ayo ka hyrë më tepër në zemrën e të gjithëve me një "këngë të personalizuar" për Tiranën. Ndërsa kur filloi të këndojë hitin e saj botëror "WHO", nuk kishte se si të gjithë të pranishmit të mos ngriheshin në këmbë. Edhe pse binte shi, në një atmosferë pothuajse romantike dhe pak të ftohtë, këngëtarja arriti të ngrohë zemrat e të pranishmëve nëpërmjet këngëve të saj të luajtura nën tingujt e kitarës. Pavarësisht kohës, dhe të pajisur me çadra e me xhubokse, të ftuarit ishin të shumtë në "Amfiteatrin" e Liqenit Artificial për të shijuar atmosferën e papërsëritshme që dha mbrëmjen e së enjtes këngëtarja e hiteve si "WHO", "Down on My Knees", "Slow Slow". Në koncert elektrizues nuk kishin se si të mungonin edhe figura të njohura të artit si çifti i këngëtarëve Venera Lumani dhe Lind Islami, këngëtarja Orgesa Zaimi, aktori Gazmend Paja etj., të cilët nuk ngurruan ta shpërndanin nëpër rrjetet sociale këtë ndjesi unike që këngëtarja Ayo përhap në mbrëmje nën tingujt e kitarës. Ndërkohë që kujtojmë se Ayo, artistja e njohur e fillim viteve 2000, ka spikatur për talentin e saj në muzikë si instrumentiste që në



moshë të vogël, madje ka shkruar këngën e saj të parë në moshën 15-vjeçare kushtuar nënën e saj, ndërsa për sa i përket shijeve muzikore është ndikuar nga Pink Floyd, Felé Kutí, Donny Hathaway, Jimmy Cliff, Bob Marley. Albumi i saj i parë "Joyful" u regjistrua në 2006, dhe prej 2007 turnetë e saj anëmbanë botës nuk kanë ndalur. Albumi i dytë Gravity At Last erdhi suksesshëm në 2008 duke qenë për një kohë të gjatë në toplistën franceze dhe në ato gjermane. Albumi i tretë Billie Eve, ishte sërish një sukses për Ayo-n, kjo falë edhe bashkëpunimeve me emrat e njohur si Craig Ross (kitarist i Lenny Kravitz), reperi Saul Williams, Matthieu Chedid dhe Gail Ann Dorsey.

Këngëtarja Ayo, e njohur dhe e pëlqyer për stilin reggae dhe soul performoi përpara publikut në Amfiteatrin e Liqenit Artificial të Tiranës sukseset e saj si:

- * "Life Is Real" (2006)
- * "Down on My Knees" (2006)
- * "And It's Supposed to Be Love" (2007) (2008, US)
- * "Help is Coming" (2007)
- * "Sloë Sloë (Run Run)" (2008)
- * "On aime, on aide" (2009)
- * "Lonely" (2009)
- * "I'm Gonna Dance" (2011)
- * "I Éant You Back" (2011)
- * "Fire" (2013)
- * "Fire" featuring Youssoupha (2013)
- * "Ého" (2014)
- * "I'm a Fool" (2017)
- * "Paname" (2017)



Materiali me metrazh të shkurtër konkurren në festivalin e filmit të modës në Kaliforni

MODELJA HANA NOKA

vjen si regjisore, filmi i nominuar për 3 çmime në SHBA

Modelja dhe aktoria e filmave, e cila tash më po sprovohet si regjisore Hana Noka, do ta prezantojë filmin e saj të shkurtër për industrinë e modës. Premiera e këtij filmi, i titulluar "Hana", do të jepet në edicionin e nëntë të festivalit ndërkombëtar të modës La Jolla (LJIFFF), i cili do të mbahet më 19-21 korrik në vende të ndryshme në La Jolla, Kaliforni.

Filmi është nominuar në tri kategori – Kinematografia më e mirë; Montazhi më i mirë dhe Muzika më e mirë.

LJIFFF mbledh regjisorët e modës nga e gjithë bota. Qindra filmbërës të modës do të vijnë nga e gjithë bota për të shfaqur punën e tyre më elegante. Festivali tregëtor i filmit është një nga festivalet më të mëdha të filmit privat në botë. Për më shumë informacion, mund të vizitoni LJIFFF.com.

Noka në film shfaq një letër dashurie të bukur në botën e modës, si dhe rrugën e karrierës së saj si modele.

Çmimet do të ndahen më 21 korrik.

LJIFFF konsiderohet si "Kanë e botës së filmit të modës" dhe mbledhja më e madhe e regjisorëve të modës. Qindra filmbërës të modës do të vijnë nga e gjithë bota dhe do të zbrisin në bashkësinë e pasur të San Diegos për të shfaqur punën



e tyre më elegante. Festivali tregëtor i filmit është një nga festivalet më të mëdha të filmit privat në botë. Drejtuar nga Luey Nohut, "Hana" është frymëzuar nga një citim i thjeshtë nga ish-regjisori kreativ Alber Elbaz i shtëpisë së modës Lanvin: "Stili është diçka që pasqyrohet nga shpirti ynë në botën e jashtme - një emocion." Me një ndihmë të vogël nga miqtë, Noka donte të krijonte një letër dashurie të bukur në botën e modës në film, një industri që ka qenë një rrugë për karrierën e saj të suksesshme si një modele.

Vitin e kaluar, në bregun e bukur dalmat të Kroacisë, Noka dhe bashkëshorti i saj, Shkumbini, së bashku me regjisorin Nohut dhe kompozitorin muzikor Ryszard Zych, vendosën të shfaqin stilin dhe bukurinë e modës në një shkallë më të gjerë, përmes "Hana" - përdorimi i filmit si një medium për të shprehur natyrën transcendentale të stilit dhe modës. Në vend që të mbështetej në fotografinë, mesazhin e provuar dhe të vërtetë për kapjen e esencës së modës së lartë dhe një veshje të mrekullueshme të ditës, Noka donte të eksperimentonte me filmin për të kapur lëvizjen dhe humorin e frymëzimeve të saj estetike. I xhiruar në Split, Kroaci qyteti i bukur shërben si sfond i përsosur për këtë xhirim të gjatë.

"Për inat të atyre që më urrejnë", Roza Lati merr certifikatë mirënjohjeje

Nuk është hera e parë që lakohet nëpër rrjetet sociale për Ndhimësën që ajo jep për kafshët në nevojë por jo vetëm. Dhe të shumtë janë ata që e 'sulmojnë' duke thënë se nuk bën sa duhet duke qenë të pakënaqur me të. Por kjo gjë nuk e ka ndaluar Roza Latin, e cila së fundmi ka postuar në faqen e saj në 'Instagram' një foto me një certifikatë në dorë. "Mirëmëngjesi ju që më urreni. Kur të ma kaloni mua, guxonin dhe villni vrer nëpër komentet tuaja kur bëhet fjalë për bamirësi. Këtë foto po e postoj se vetë me shtytë", ka shkruar nën foto moderatorja.



Nuk është e nevojshme që të shfaqë prova për bamirësitë që bën, por mesa duket ndjekësit e kanë nxitur të tregojë një vlerësim që i kanë bërë për impenjimin e saj për kujdesin që shfaq ndaj fëmijëve jetimë. Kjo certifikatë e dhënë nga jetimorja e Gjirokastrës tregon impenjimin e Rozës në këtë kauzë.



Në hapat e së ëmës, Çiljeta poston video me djalin të sapodalë nga dushi

A është krenaria dhe dashuria e saj më e madhe. Dhe këtë nuk harron ta shprehë edhe me fotot e videot që i bën herë pas here. Këngëtarja e njohur, Çiljeta Xhilaga ka postuar së fundmi një video të djalit të saj, Fernando, ku ky i fundit shfaqet duke kërcyer e kënduar i mbuluar vetëm me peshqir. Mesa duket pasioni i djaloshtit nuk do të jetë vetëm futbollit, por, gjithashtu, parapëlqen të eci edhe në hapat e së ëmës. Me shumë pasione dhe talente, të shohim çdo të zgjedhë kur të rritet bukuroshi i këngëtares.

Opinion i Ditës

Anëtarësimi në BE, si lexohet jashtë propagandës së partive

Nga Përparim KABO

(Vijon nga faqja e parë)

... nga ditët e para të nëntorit 2018. Ne pritëm gjatë ditëve të qershorit 2018 në kuadër të 140-vjetorit të Kongresit të Berlinit duke besuar në atë që njihet prej ca vitesh si procesi i Berlinit. Përgjigjia erdhi. Shihemi nga qershori i 2019-s! Palët politike tashmë të ndara e në armiqësi do të vrapojnë ta lexojnë njëra si një fitore se hapja e negociatave është kryer dhe vetëm është shtyrë në kohë për një vit-qershor 2019. Pala tjetër do e lexojë situatën si një kohë për anarki me qëllim sulmin ndaj qeverisë aktuale dhe asfiksimit institucional të vendit duke bllokuar proceset reformuese nën monitorimin e partnerëve ndërkombëtar, pa çka që edhe këta ndryshime janë duke ecur aq avash sa të duken si të pamundur të kryhen si duhet dhe kur duhet.

Ne si qytetarë të këtij vendi duhet të lexojmë me mendje të kthjellët dhe me atdheadashuri përgjigjen e BE-së me qëllim që Shqipëria, atdheu ynë ta meritojë futjen në BE, ndaj le t'i shohim kushtet e BE-së 1-Reforma zgjedhore: Leximi i parë, përgjegjësia është e atyre që e hartojnë reformën, forcat politike dhe aprovimi në parlament. Leximi i dytë, përgjegjësia është e klasës politike. Përfundimi: Nuk morëm përgjigje pozitive, sepse sistemi zgjedhor nuk ka dhënë garanci të një demokracie funksionale dhe për pasojë institucionet janë të kapura deri nga të inkriminuarit dhe të korruptuarit. Zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë nuk japin garanci. Përgjegjësia mbetet e klasës politike.

2-BE-ja kërkon luftën kundër krim-it të organizuar. Po çfarë do të thotë krim i organizuar? Organizatat kriminale të trafikëve, të pastrimit të parave dhe akteve të rënda kriminale që veprojnë në një treg lokal, rajonal dhe global, kanë shtënë në dorë segmente të shtetit dhe pushteteve, duke siguruar autoritet vendimmarrës dhe mundësi që të veprojnë jashtë kontrollit ligjor e policor. Ata që janë në shtet dhe i ndihmojnë e bëjnë këtë krim të quhet i organizuar. Përfundimi: Përgjegjësia është e institucioneve, organeve ligjzbatuese, atyre të taks-tatimeve, bankave dhe medias.

Kushti tjetër i BE-së.

3-LUFTA KUNDER KORRUPSIONIT. Pra, kemi një sistem korruptiv që ka kapur drejtësinë, e cila është futur në proces vetimgu me ritmin e breshkës dhe duhen 10 vite të mbyllet. Kemi klasë politike me pasuri të pajustifikuar që një popull që varfërohet duke krijuar një shoqëri me një polarizim ekstrem, vërtetuar kjo gjendje edhe nga institucione prestigjioze ndërkombëtare. Përfundimi: Sërish përgjegjësia bie te klasa politike, te qeverisja, organet e drejtësisë dhe ato të hetimit inteligjent.



Kryepërfundimi. Pyetja e thjeshtë e para dhe e fundit, qershor 2018-qershor 2019, a mund të kryhen këto detyra shtëpie te ne me këta institucione dhe me këtë klasë politike që kemi? Unë them jo. Pra, në mendim alternativ, por me argumente bindëse dhe jo me entuziazëm që e shtyn procesin mbase në një kohë pa shifër. Historia vazhdon.

Integrimi në BE, prona te i zoti legjitim, jo te hajduti dhe antiligjori.

A funksionon marrëveshja e besimit në vendin tonë? Pra, a ka një besim reciprok mes qytetarit dhe shtetit. John Lock thoshte se që besimi të funksionojë kërkon respektimin nga qeverisja e tri liri: liria e jetës, liria e pronës dhe liria e shprehjes. Në kuadrin e anëtarësimit të vendit tonë në BE më së fundi zyra e BE-së në Tiranë para ndoca ditësh u zgjua edhe për problem-in e pronave. Shkurt çelja e negociatave dhe pranimit i Shqipërisë në Bashkimin Europian kërkon në mënyrë taksative që prona të shkojë te i zoti sipas parimit universal që vjen që nga Dhjata e Vjetër, ku shkruhet se "Prona është 9/10 ligj dhe 1/10 aset. Juridikisht prona trashëgohet dhe kjo provohet ligjërisht. Prona shitet dhe blihet dhe kjo bazohet në procedura ligjore korrekte. Prona falet dhe ky akt duhet të verifikohet dhe provohet ligjërisht

Te ne në mënyrë anarkike është shtuar edhe një mekanizëm tjetër unik i paparë dhe padëgjor askund dhe në asnjë kohë. Prona zaptohet apo vidhet më saktë, dhe legalizohet po nga shteti. Tek ne shteti që nuk është pronar sillet si i tillë, dhe në vend që t'ia kthejë tokën të zotit legjitim, ia jep klientit privat me koncesion dhe ai atje lanë paratë dhe ndërton në pronën e tjetrit, si të thuash ia grabit ditën

për diell me bekimin e ligjit dhe të madhit... Maliqit...!

Le t'i shohim çështjet më radhë, një e nga një...

1-Ligji nr. 7501. Në hyrje të ndryshimeve ekonomike dhe sociale në vitet 90-të ky ligj u shpreh për dhënien e tokës atyre që plotësonin këto kushte...a) Personi banon në fshat, b) Ka gjendjen civile në fshat, c) Merrret dhe jeton me bujqësi...Leximi i parë...Po kur personi ka ikur nga fshati? Leximi i dytë. Po kur personi nuk ka më gjendje civile në fshat ose e ka atë formalisht? Leximi tretë, po në rastin kur personi ka ikur dhe jeton ose në qytet ose fare jashtë Shqipërisë, pra as që nuk merrret me veprimtari bujqësore? Si duhet vepruar me ligjin pa objekt dhe pa subjekt?!

Pra, në këto kushte ligji 7501 nuk mund të funksionojë, sepse ka rënë përmbajta sociale dhe juridike e tij sa kohë që ky është një ligj që shpreh në thelb raportin e individit me tokën. Ligji institucionalisht nuk funksionon ose mbahet me paterica në kundërshtim me kushtet juridike e sociale dhe praktikisht është shfuqizuar pikërisht nga ata që përfutuan prej tij. Kështu si mbahet ky realitet është shkelje e ligjit. Por kur ligji shkelet ka penalitete për shkelësin...Pra, nëse dikush grabit, ai shkel ligjin dhe shkon në burg ose merr një dënim alternativ se p.sh. ka vjedhur energji elektrike...Po kur shkel ligjin dhe mban tokën e tjetrit pse nuk kërkohet drejtësi, pse nuk dënohet ai që e kryen këtë shkelje ligjore?! Analiza duhet të jetë rast për rast jo për të legalizuar informalitetin si u bë këtu te ne, por rast për rast jo ai që ka shkelur kërkesat e vetë ligjit ta humbi pronësinë mbi tokën dhe ajo t'i kthehet pronarit të ligjshëm!

2- Kthimi dhe kompensimi pronave...Si funksionon? A zbatohet barazia e qytetarit para ligjit? Ja të arsyetojmë. Nëse brenda tringut familjar djali xhaxhait tënd e ka marrë pronën me kompensim fizik të plotë bazuar në ligjin e mëparshëm, ndërsa ti s'e ke marrë ende dhe, bazuar në ligjin e ri aktual, toka do të konvertohet në vlerë në bazë të zërit kadastral dhe falë një transaksioni imagjinar që e bën shteti me pronën tënde pa qenë pronar i saj, në fund po shteti vlerën ta kthen në pasuri fizike; pra po tokë, por jo sa të kanë lënë të parët e tu, por aq sa të llogarit shteti d.m.th. më pak. Në këto rrethana bazuar në të njëjtën Kushtetutë ka dy qasje dy realitete dhe jo barazi para ligjit: njëri e merr të plotë, tjetri një çyrek!

Leximi parë. Nëse tokën time ti, komision administrativ dhe jo kuazi-ligjor si gjykatë, pra Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e kalkulon nga tokë në vlerë dhe nga vlerë tregu sërish në tokë, a mund të më thuash: Kush ta ka kërkuar që të më bësh këtë transaksion? Unë si qytetar jo! Leximi dytë, ti, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të pronave që me ke bllokuar pronën dhe nuk dihet kur do ma çliros, a mund të më përgjigjesh për një pyetje: Nëse ke të drejtë të më llogarisësh vlerën në raport me kërkesë ofertën e tregut sot dhe të më japësh aq sa llogarit ti, Po unë si qytetar pse s'kam të drejtë të logaris fittim e munguar për mos kthim të pronës prej 25 vjetësh?! Edhe unë dua të më llogarit në vlerë dhe të më transkripton në tokë fizike. Po ta bëjmë këtë llogari jo që do ma ktheshtë të gjithën tokën që kam trashëgimi, por jam me bindjen se edhe më shumë do rezultojë!

Përfundimi. Ja pra se integrimi Shqipërisë në BE nuk është thjesht çështje 28 qershori 2018 apo 2019...Pa pronën private te i zoti legjitim Republika e Shqipërisë është një shtet jo normal dhe jashtë demokracisë përmes ligjit. E përsëris: Prona 9/10 është ligj dhe 1/10 është asset dhe jo si te ne 9/10 është Maliq dhe 1/10 mere me lëng se mishi u mbarua!! Në çdo rast kur flitet për detyrat e shtëpisë së Republikës së Shqipërisë dhe plotësimin e kushteve në procesin e integritimit të vendit tonë në Bashkimin Europian, nuk mungon kërkesa për ndërtimin e një administratë që qëndrueshme, profesionale, të depolitizuar, kompetente dhe në shërbim të publikut, e pa moltipuar me korrupsion. Një administratë europiane, e cila në qendër të punës së saj ka qytetarin dhe interesin publik. Ky kusht konstant me gjithë ndonjë ndryshim sipërfaqësor, gjatë gjithë tranzicionit është në gjendje shumë mjerane. Njerëzit herë-herë gënjehen me formën e shërbimit që fal teknologjisë mund të shkurtrojnë kohën dhe procedurat, por në

thelb në kemi një administratë që karakterizohet:

1-Nga rekrutimet partiake, nepotike dhe korruptive. 2-Ne kemi një administratë që drejtohet që nga nivelet më të larta nga inkompetentë, nga persona pa stabilitet dhe që drejtojnë me një frymë komandimi të tipit otomanist(rituali i kokës së prerë). 3-Administrata jonë, sidomos ajo e larta e ekzekutiv-it gjatë gjithë tranzicionit është dalluar negativisht për paqëndrueshmëri ligjore. Çdo ministër që hip në fuqi, gjënë e parë që bën është ndryshimi i ligjit organik të institucioneve me qëllim rritjen e kompetencave personale, sigurimin e një kontrolli absolut mbi gjithçka dhe mbi këdo si dhe sigurimin me shteg ligjor dhe administrativ të kanalit ku kalojnë fondet monetare, të cilat pa më të voglin dyshim duhet të derdhen edhe në "thesin e tij apo të saj". Kështu, këta "sans culotte" sa hap e mbyll sytë përfundojnë me vlla dhe me pasuri përalllore. Si të tillë ata krijojnë shembullin dhe shpërfaqë i ndihmon të rrjepin pa dal në shesh duart e tyre "të pasura". 4- Në administratën tonë nuk ka klimë meritokracie, sepse drejtuesit më të lartë madje dhe brenda vetë partive janë mediokrit. Ja p.sh. shikon sekretarin e përgjithshëm të PD-së dhe të PS-së. Si të tillë ata duan dhe mbledhin rreth veshes njerëz me kulturë mesatare, persona me njolla në jetën e tyre me qëllim që t'i përdorin nën trynë, si dhe shërbëtorët e padenjë që dinë të thonë vetëm "yes sir" pra servilët në disa breza. (ja se ç'më shkruan në inbox një ish-studentja ime, e paraqes integralisht): "Shumë e vërtet profesor! Çfarë administrate kemi ne e provova mbi lekuren time. Nuk pranova të firmos për një rast korruptiv, pa procedurë, në shkelje të ligjit për një kontratë me qindra miliona dhe sot jam e papunë. Kam fituar gjyqin në shkallë të parë, tani jam në Apel, por kur marrin vesh arsyen e largimit nga puna (se kundërshtova urdhrin e paligjshëm të titullarit) kanë frikë të më marrin në punë. Kjo është Shqipëria, për të cilën jam penduar që u riktheva." Ajo studioi në Norvegji dhe u kthye për të kontribuar! Zhgënjimi ka peshë të rëndë dhe shijë të hidhur.

Indivëdit e zotë, ata me kurajë dhe me personalitet, ata që kanë vizion dhe ide, që ndërtojnë dhe sendërtojnë plane dhe projekte largpamëse, që nuk zbatojnë urdhrat korruptiv, para atë që prishin qetësinë e kënetës, ata dhe ato nuk na duhen në administratë. Atyre duhet t'u mbyllet goja dhe a ka mundësi t'i mbajmë sa më larg, t'u krijojmë një gjendje stresante, një lloj frike dhe paragjykimi, ti atakojmë dhe denigrojmë. Shkurt t'i përzëmë që ta lënë punën dhe pastaj kokën le të përplas in ose andej nga shoqëria civile ose të marrin "rrangul" në krahe dhe si shterisen andej nga Kanadaja apo Amerika. ➔

5-Sjellja ndaj administratës ➔

Dje në 'Deutsche Welle'

Putini fiton, Trumpi jo

Nga Miodrag Soric

(Vijon nga faqja e parë)

... t'i mbështesë kryengritësit në Lindje të Ukrainës, njësoj si edhe Presidentin Asad dhe trupat e Iranit në Siri. Në "Russia first" (Rusia e para) të Putinit Trumpi, zor se mund të ndryshojë gjë. Përkundrazi, shefi i Kremlinit mund të presë shumë gjëra nga një takim i nivelit të lartë ruso-amerikan. Kur ai dhe Trumpi të diskutojnë kokë më kokë, për të folur për çarmatimin atomik, do të jenë pamjet televizive që do të transmetojnë në të gjithë botën mesazhin: këtu po negociojnë dy politikanë në nivel të barabartë. Me këtë Putini do të fitonte, pa varësisht nga fakti nëse arrihet apo një rezultat.

KOMPROMISE AMERIKANO-RUSE NË KURRIZ TË TË TRETËVË

Njëkohësisht, me këtë takim në momentin e tanishëm Putini e përçan edhe më tej kampin perëndimor: synimi i Britanisë së Madhe për ta izoluar Rusinë pas aferës Skripal do të eliminohej pikërisht nga "vëllai i madh" përtej Atlantikut. Edhe ukrainasit do të ndihen të mashtuar nga SHBA-të, në mos fare të tradhtuar. Kjo në një kohë kur Kiev i duhet t'ia pranohet vetes: Uashingtoni e ka mbështetur Ukrainën gjithmonë vetëm me fjalë të forta - rrallë duke i dhënë para. Putini vërtet mund të jetë i gatshëm për lëshime në konfliktin e Ukrainës, por vetëm nëse amerikanët do të hiqin dorë si shpërblim nga rezistenca e tyre kundër gazsjellësit "Nordstream 2".

Sido që të bëhet, SHBA do t'i vazhdojnë sanksionet e tyre kundër Rusisë, edhe pas takimit të nivelit të lartë. Kongresi në Uashington nuk mund t'i tërheqë ato brenda natës, për shkak procedurale teknike.



Aktualisht tek deputetët nuk ekziston as vullneti politik për këtë.

Pse e do Trumpi atëherë këtë takim të nivelit të lartë? Nga njëra anë ai do që ta mbajë premtimin që ka bërë në fush-

atën elektorale. Dhe këtu bën pjesë përmirësimi i marrëdhënieve me Rusinë. Nga ana tjetër, ai duket se i ka të nevojshme inskenimet spektakolare politike për egon e tij. Këtë narcizëm autokratë dhe shfrytë-

zojnë për synimet e tyre. Diktatori i Koresë së Veriut, Kim Jong Un thajse nuk e ka ndryshuar pozicionin. Megjithatë, Trumpi e shiti takimin me të si sukses historik. Putini e regjistroi këtë dhe do të veprojë po në të njëjtën mënyrë.

← në të gjitha nivelet është mbytëse. Atë që ta jep ligji nuk ta lë spahiu. Atë që ta njej Kushtetuta nuk të lë ta ushtros pashai. Dhe atë që ta njej rangu zyrtar ta merr si pa të keq eprori më i lartë apo deputeti i zonës që sillet si sherifi zonës. 6-Administratës sonë i mungon vjueshmëria. Çdo institucion kur akreditohet vlerësohet nëse ka një qëndrueshmëri në stafin e vet. Apo njerëzit ndërrohen sipas stinës politike dhe tek ne edhe sipas motit kapricioz brenda stinës me tipare të kloritit shumëgjyresh politik në rastet kur drejtohet në koalicion partiake. Tek ne faturinot dhe shoferët bëhen deputetë, anglishtfolësit merren me ministrinë e rrugëve, artistët me ekzekutivin, mjekët drejtojnë botën globale, ata që s'kanë punuar as një ditë në punë shteti bëhen kryeministra. Vetëm ekonomistët, politologët, filozofët dhe inxhinierët nuk pyeten, sepse ata nuk i duhen punëve të shtetit. Ne jemi një shtet që drejtohet nga gjys-

makët, nga anonimët dhe nga të paaftët, që dinë shumë mirë vetëm të zhatvin.

7-Si ndërtohet një administratë? A ka përvoja që mund të merren? Po ka. Aspektin shkresor dokumentar e kemi pasur shumë serioz edhe në mbretëri dhe në diktaturë. Por me që duam të bëhemi shtet modern pa u bërë shtet normal është me vend që të kemi ca pika referimi. Shkencërisht le t'i referohemi Max Weberit... (inshalla ndonjë zyrtarë yni ja ka dëguar emrin dhe ka lexuar ndonjë libër të tij, sepse është themeluesi i sociologjisë moderne), i cili ka nënvizuar se një administratë moderne duhet të ketë në strukturën e vetë: Menaxherët e karrierës (lexo administratorët me përvojë të gjatë pune dhe eksperiencë profesionale. Politikanët që përgatiten duke kaluar nga shteti i menaxherëve me karrierë (tek ne pa të dërsirë mustajta të marrin të prokurorsh miliona pastaj të fusin një shkëlqim të denjurave dhe të hedhin në rrugë, ose të gjejnë në askund dhe të japin një

detyrë vetëm e vetëm që të të përdorin. Politikanët tanë në këta 28 vite janë të frikshëm, sepse vijnë nga asgjë dhe bëhen drejtues të lartë pa as një lloj kontributi dhe merite që mund të bindin se ai apo ajo japin garanci së paku për kompetencë. Dhe struktura e tretë janë eruditët, që në administratën tonë mungojnë në mënyrë absolute. Mungojnë Think tank-et dhe institutet kërkimore. Sa keq. Pa dashur të absolutizojë por dikur kishim elita shkencore, inxhinierike, mjekësore, bujqësore dhe veterinarë, gjeologjike dhe gjeodezike, ushtarake dhe artistike, albanologjike dhe filologjike që nisen të ndërtoheshin që në kohën e mbretërisë duke u shkolluar jashtë vendit dhe që vijuan edhe në përdhënë e diktaturës. Tani kemi me kokra ca që kanë studiuar jashtë dhe janë kthyer por elita nuk kemi. Administrata jonë nuk mund të ndërtohet sa kohë që ka spastrime ciklike, sa kohë që çdo parti politike ka ushtrinë e vet administrative dhe çdo hierark ka shpurën e tij; sa kohë që

njeri thotë kush nuk mban ritmin të vendin e punës dhe e zbrazi në 2005-n administratën dhe tjetri flet për Shqipërinë e gjenatës së re dhe e ka lënë atë pa specialist. Ne do jemi pa administratë funksionale të besueshme dhe në shërbim të qytetarit dhe interesit publik, përpos pa dalë nga fryma otomane dhe sa kohë do mungojë kultura europiane si dhe pa e siguruar vendin e punës me ligj dhe jo me Maliq. Nuk ka mundësi të ngremë një administratë të tipit dhe fizionomisë europiane pa kulturë europianiste. Shteti normal kërkon ligje dhe zbatim të tyre institucionalisht. I duhen njerëz të zotë dhe të përkushtuar, administrata ka nevojë për konkurrim meritokratik dhe për hierarki vlerash. Shteti ndërtohet nga politikanët të besueshëm. Siç thoshte Mehdi Frashëri: Shqipëria do bëhet kur të mënjanojë nga drejtimi ata që merren me dokrra dhe do të shpjerë në litar hajdutët. Udhëtimi qenka i gjatë. Historia vazhdon...!

HOROSKOPI

DASHI

Shqetësimi nuk do të jetë i lehtë për t'u mbajtur nën kontroll. Do të bëjë që marrëdhëniet me të tjerët t'i kenë sipas kapricëve të humorit. Qetësohuni! Nuk do të pranoi propozimin e një të njohurit, sepse më vonë do t'i ndiheni në borxh.

DEMI

Ironia e juaj therëse, sot bëhet më e hidhur nga ndikimi negativ i Merkurit. Në vend që t'i përgjigjeni ftesave të njeriut të zemrës, do të parapëlqeni të rini me miqtë. Më pas do të përqipeni të fitoni kohën e humbur, por nuk do të jetë e thjeshtë.

BINJAKET

Në familje do të kenë disa kundërshtime të shkaktuara nga këndvështrime të ndryshme. Mos u mërzisni: larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni kolegët që iu rini pranë duke iu dhënë ide dhe mundësi të mira.

GAFORJA

Sot yjet nuk janë shumë të shkelqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bini shumë në sy, rritni të qetë dhe shfaqni aftësitë tuaja në momentin e duhur.

LUANI

Më mbështetjen e Merkurit, por me armiqërinë e Marsit dhe Venusit, Hëna në qiellin tuaj do të bëjë që të ndiheni fajtor në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë.

VIRGJERESHA

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke iu vënë shkopin në rrota. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri përkap dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

PESHORJA

Do të kaloni pengesat dhe do t'ia dilni më në fund të vëni në zbatim një ide që e keni lënë mënjane prej kohësh për shkak të pasigurive. Një takim i papritur do t'ju shtirëngojë që të përballemi me probleme të hershme dhe t'i zgjidhni ato.

AKREPI

Kujdes nga çështjet që kanë të bëjnë me financat, sepse mund të shkaktohen vonesa dhe pengesa në pagesa. Më mirë të merrni vetë më këto gjëra. Shqetësimi në fushën e dashurisë, për shkak të Venusit kundra, mund të bëjë që të merrni vendime gjaknxehta.

SHIGJETARI

Qëndroni afër një bashkëpunëtorit që ka zakon të flasë pak si shumë. Ka trezik që të përhapë fjalë jo shumë të mira për ju. Mund t'i kërkontë këshillë kujt të doni, por mos lejoni të ndikoheni për zgjedhje që kanë të bëjnë me fushën e dashurisë.

BRICJAPI

Jupiteri do të bashkëveprojë me Diellin e Hënës, duke ju favorizuar së tepërmi. Sot do të jeni optimist, dhe do t'ia dilni të merrni çdo gjë që keni me angazhim minimal. Potenciali krijues është në nivelet më të larta për këtë muaj.

UJORI

Hëna do të ndikojë në ritmet e ditës, do të bëhen të paqëndrueshëm. Do të jetoni momente kënaqësie, por edhe caste pasigurie. Mos e shmangni afirmim e një personi që keni njohur së fundmi, mund t'ju bëjë kureshtarë më shumë sesa mendoni.

PESHQIT

Nëse jeni begar, dikush do t'ju afrohet me ndjenja të sinqerta, po ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizontin shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos i lini t'u ikin.

Ka gjithmonë një herë të parë dhe për Uruguain e Portugalinë duhej të vinte në fazën e 1/8-ave të "Rusi 2018". Dy Kombëtalet nuk janë përballur kurrë mes tyre qoftë në takime zyrtare, qoftë në miqësore, ndaj kjo ia shton edhe më shumë dozën e befasisë këtij 90- minutëshi. Nga njëra anë Suarez-Kavani, nga tjetra Ronaldo-Kuarezhma, ndaj dilemat janë të mëdha dhe spektakli i garantuar. Trajneri Osk-



Tabarez "snobon" Ronaldon: Nuk kam frikë prej tij

Uruguai dhe Portugalia e bëjnë "sefte" në Botëror

ar Tabarez është i fokusuar te ndeshja dhe jo te Kristiano Ronaldo. "Kristiano Ronaldo është në elitën e sulmuesve më të mirë të historisë, por kjo nuk ma prish gjumin natën. Nuk e kam obsesion. Mendoj se do të

jetë një ndeshje e bukur, por nëse do të luanim keq dhe të fitonim, do të isha njësoj i kënaqur. Çdo lojtar sjell në fushë eksperiencën e tij dhe ka motivimin e tij. Portugalia është kampione e Europës dhe

është një ekip i madh. Ajo që mund të them është se jemi mirë dhe se do të provojmë gjithçka". Fernando Santos ka një detyrë, të çajë Uruguain. Skuadra e Tabarezit është mbrojtja më e fortë në këtë

Kupë Bote, ndaj atij i duhet të krijojë skemat e duhura. "Do të jetë një lojë e madhe nga dy ekipe mjaft të mira, që do të përpigjen të fitojnë. Uruguai është një fortesë e vërtetë, por ne kemi për detyrë të fitojmë. A jemi ne të varur nga Ronaldo? Të gjitha skuadrat varen nga lojtarët e tyre më të mirë, siç varet dhe Tabarez nga Suarez dhe Kavani. Gjithsesi, Ronaldo nuk mund t'i fitojë ndeshjet i vetëm pa 10 shokët e tjerë të skuadrës".

Dy kombëtare, të dyja fituese të Kupës së Botës, do të kërkojnë një biletë për në çerekfinale



Jeton Selimi

Francë-Argjentinë, "finalja" e parakohshme

Në "Kazan Arena" ndizet faza e 1/8-ave

Francë-Argjentinë është finalja e parakohshme e kësaj Kupë Bote. Nuk ndodh shpesh që në turin e 1/8-ave të përballen dy fituese të trofeut dhe natyrisht që keqardhja është e madhe për cilëndo prej kombëtareve që do të mbësë jashtë. Në historikun mes tyre, Franca dhe Argjentina janë përballur 11 herë, me "Albiselesten" që ka fituar në 6 raste. Tri përballje janë mbyllur në barazim, ndërsa "Gjelat" kanë triumfuar në dy takime. Ndaj, parë shifrat dhe forcën e rivalit, trajneri i Francës, Didier Deschamps, i druhet Argjentinës, por mbi të gjitha yllit të ekipit, Lionel Mesit. "Mesi është unik, nuk mund të krahasohet me të tjerët. Mesi është Mesi. Shikoni numrat dhe statistikat e tij. Shpresojmë të arrijmë ta neutralizojmë, por e dimë se ai mund të bëjë diferencën edhe në hapësira të ngushta. Ekipi i Argjentinës nuk është ndërtaur përreth Mesit. Por, ai gjithsesi ka një im-



pakt të madh. Argjentina ka edhe eksperiencë e stil amerikano-jugor, dua të them se janë luftëtarë. Do

të përpiqemi t'i vështirësojmë jetën Mesit". Edhe kapiteni Loris në fjalën e tij përpara mediave i ka kushtuar rëndësi "Pleshtit" argjentinës. "Mesi është unik. Nuk mund të krahasohet me asnjë. Shikoni se

çfarë ka bërë për Barcelonën, por ne e kemi studiuar dhe jemi përgatitur mirë që të përballemi me të. Për të fituar duhet të bëjmë një performancë të madhe". Fitorja në frymën e fundit kundër Nigerisë i ka dhënë entuziazëm dhe frymëmarrje Argjentinës dhe trajnerit Horge Sampaoli, por në Botëror nuk ka kohë dhe në 1/8-at erdhi përballja me Francën. "Kemi besim të forca jonë dhe do ta luajmë ndeshjen me zemër. Duhet teknikë, por një rol të madh do të luajë edhe aspekti emotiv ndaj jemi gati. E dimë se çfarë do të bëjmë. Sa i takon modulit, ne ndërrojmë shpesh

gjatë ndeshjes dhe unë ia komunikoj këtë Mesit dhe të gjithë skuadrës. Franca është e fortë edhe në lojën në ajër dhe di të nisat shumë mirë me kundërsulm. Duhet të jemi mjaft të kujdesshëm, pasi janë në gjendje të bëjnë gol me 3-4 pasime". Në konferencë ishte edhe Ever Banega, mesfushori që në ndeshjen ndaj Nigerisë dha edhe asistin për golin e Leo Mesit. "Në Kombëtare të gjithë duhet të japim gjithçka nga vetja që t'ia dalim mbanë. Mesi është një djalë i ndrojtur, por ka mënyrën e tij për të dalë në pa. Ai është lideri ynë".

Rezimeja e fazës në grupe

Ja çfarë mësuam nga 48 ndeshjet e para

Muzika e grupeve mbaroi dhe gjysma e të ftuarve në Rusi janë larguar: 48 ndeshjet e para të Botërorit janë arkivuar dhe aeroportet janë mbushur me skuadra dhe tifozë që në duar kanë valixhet, kush të mbushura me 'kënaqësi', ose kush me 'dëshpërim'. E rëndësishme është që turi i parë në Rusi na ka dhuruar rekorde, mësimë si dhe VAR-in. Por tani është koha të bëjmë llogaritë e para. **Kombëtalet që kanë befasiuar më shumë** Belgjika dhe Kroacia janë dy ekipet që kanë

bindur më shumë në këtë kupë bote. Por le ta themi më qartë. Kroacia ka një tjetër nivel. Dhe jo vetëm për atë fitore 3-0 ndaj Argjentinës. Modriç po dhuron një futboll të ëmbël, të denjë për "Topin e Artë", ndërsa e gjithë skuadra po luan duke shfaqur një dozë të lartë cilësie. Egërsia e Manxukiçit, shpërthimet e Perisiçit, një mesfushë ku Kovaçiq është lojtarë stoli dhe Badelj, Brosoviç e Rakitiç janë mbështetësit e mrekullueshëm të Modriçit, e shndërrojnë Kroacinë në një favorite të madhe. Në çerekfinale mund të ndeshet me Spanjën dhe në këtë rast,


askush nuk duhet ta humbasë një përballje si kjo. **Duhet të falënderojmë VAR-in** Ka ende tifozë që nuk e kuptojnë, të tjerë që nuk e pranojnë. Madje, ka edhe nga ata që e kërkojnë në çdo aksion. E megjithatë, ky VAR-i nuk qenqësh kaq i keq apo jo? Pyesni Spanjën, që kaloi si e para e grupit falë vlerësimit si të rregullt të golit të Iago Aspasit në kohën shtesë, jo anësori kishte dhënë pozicion jashtë loje. Ky është vetëm një nga shembujt. Sigurisht, ndonjëherë nuk u kërkua fare si në Gjermani-Suedi dhe ndonjëherë u tregua zemërmadh si në rastin e Ronaldos kundër Iranit,

madje dhe i nënshtuar nëse shohim numrin e madh të penalltive të dhëna, të cilat kanë arritur rekordin për një Kupë Bote dhe kjo vetëm në fazën e grupeve. Por duhet ta themi. Me VAR-in, Botërori është pastruar nga një seri gabimesh, që pa teknologjinë do të kishin bërë të shpërthenin polemikat. **Ronaldo-Mesi, sfida pa mbarim** Mund të përballen mes tyre në çerekfinale dhe kjo do të ishte padyshim kulmi i rivalitetit të tyre sportive. Në dy javë kemi parë shumë prej të dyve. Tripletonë e bujshme të Ronaldos ndaj Spanjës, zhgën-

jimin e Mesit nga pika e bardhë kundër Islandës, goli me kokë i CR7 kundër Marokut, psikodramën e argjentinës dhe deri te gabimet e portugezët kundër Iranit dhe rilindjen e Mesit dhe të një kombi të tërë kundër Nigerisë. Bukur, mjaft e bukur! Deri më tani më lart ka qenë Ronaldo, nuk ka dyshime për këtë, por ende nuk kemi parë asgjë. **Shpërthime bomberash** Jo vetëm Ronaldo me katër gola në tri ndeshje. Botërori 2018 ka rigjetur qendërsulmuesit e zonës dhe goleadorët. Në botërorët e fundit, sulmuesit mbetën me statistika normale, por ja që në Rusi kanë shpërthyer. Lukaku ka shënuar katër gola në dy ndeshje, ndërsa Kejn plot pesë gola dhe asnjëri prej tyre nuk e luajti ndeshjen e fundit. Sigurisht që argëtimin pa fund na

pret me Diego Kostën, Suarezin dhe Kavanin, që janë gati të shkrepin në portat kundërshtare. Po Nejmar? Përveç modelit të flokëve, deri më tani ka shkrepur bosh. **Maroku dhe Irani, thjesht "chapeau"!** Le të ngrejë dorën ai që në fund të ndeshjes Iran-Portugali nuk ka menduar për një moment të vetëm: "Mekat, këta meritojnë të kalojnë grupin"! Sepse kështu ishte. Maroku dhe Irani kanë ngrohur zemrat e të gjithë tifozëve. Dhe jo vetëm për simpati të thjeshtë, por për futbollin që kanë bërë. Skuadra të gatshme për një Botëror, të vendosura mirë taktikisht, fizikisht shumë lart dhe me vlera teknike të kënaqshme. Koreja eliminoi Gjermaninë, Meksika shkëlqeu, Panamaja shënoi golat e parë në Botërorin e parë. Jo keq, apo jo?

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Niven që që aktor.
5. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllën me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkucje.
27. Njëlljo për latinët.
30. Eshhtë vend si Katar.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.

35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium.
37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brinjë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Quheshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si gjoja.
28. Pak daktilografi.
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak maramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jenicerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafili.
27. Kufizojë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përlogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.

VERTIKALI


34. Me të nxjerrin një letër.
35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në diete.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.
5. Binjaket në klasa.
6. Qe duhet sajdisir.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë lahtar.
28. Janë inate të akumuluar
30. Eshhtë vëlla i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh basket separatistë
47. Një eshtrë edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			5	1	9			
					3			
				2	4	9		
1	2		5					9
			6		9	3		
	4				3	1		8
			9					7
6		7			1	4		
		2	9	5				1

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	4	1	6	9	3	8	2	5
2	3	8	1	7	5	9	4	6
5	9	6	2	8	4	3	7	1
8	5	3	9	6	7	2	1	4
4	6	9	3	1	2	7	5	8
1	7	2	4	5	8	6	9	3
3	8	4	5	2	9	1	6	7
9	1	5	7	3	6	4	8	2
6	2	7	8	4	1	5	3	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik




- Nëse pajtohem me ty, do të ishim të dy gabim.

- Nëse më interesonte se çfarë thonë pas shpinës time, nuk do ta kisha kthyer.

- Për të thënë të vërtetën, ka nevojë për dy: një për ta thënë, dhe një tjetër për ta dëgjuar.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mençura

- Gjerdani më i çmuar që do kesh rreth
- qafës, janë krahët e fëmijës tënd
- - Nuk ka rendesi kush te zhenjeu , apo
- kush te rrezoi ,rendesi ka kush te beri te
- buzëqeshesh serish

- - Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë...
- - Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI!
- - Gabimet e te shkuarses... Rezikojne
- lumturine e te ardhmes...

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

